



2018

RAPORTI VJETOR

abi AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS



RAPORTI VJETOR 2018

4

Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm
Ekzekutiv të ABI Bank

6

Qeverisja Korporative

8

Burimet Njerëzore

14

Përgjegjësia Sociale 2018

24

Rrjeti i degëve

26

Pasqyrat Financiare 2018

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

DHE AKTIVITETI KRYESOR
FINANCIAR GJATË VITIT 2018

ANDI BALLTA

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Kam privilegjin dhe kënaqësinë të ndaj me ju, arritjet e ABI Bank gjatë vitit 2018 dhe zhvillimin e bankës në tre vitet e fundit.

Gjatë vitit 2018, ABI Bank raportoi një fitim prej 4.4 milionë Euro. Ky rezultat na gëzon shumë, pasi vjen në vitin e bashkimit me bankën NBG Albania. Pra, është një lajm i mirë jo vetëm për punonjësit e ABI Bank, por edhe për kolegët e ish NBG Albania, të cilët u bënë pjesë e një historie suksesi. Siç tashmë të gjithë janë në dijeni, bashkimi i ABI Bank me bankën NBG Albania rezultoi një vendimmarrje e suksesshme në bankingun shqiptar, e cila për herë të parë në Shqipëri, bashkoi kapitalet njerëzore, organizative dhe financiare të dy bankave me prezencë tregu të konsiderueshme në tregun shqiptar.

Bashkimi i ABI Bank me ish NBG Albania solli një rritje domethënëse të prezencës së ABI në treg. Si rezultat, totali i aktiveve të ABI Bank në fund të vitit 2018 rezultoi në nivelin e 635 milionë Euro, ndërsa kapitali në nivelin e 76 milionë Euro. Në fund të vitit 2018, ABI Bank përmirësoi renditjen në tregun bankar bazuar me aktive nga vendi i nëntë në vendin e shtatë. Bazuar në madhësinë e kapitalit, pozicioni i ABI në tregun bankar është akoma më i lartë.

Viti 2018 shënon vitin e tretë radhazi me fitime për ABI Bank. Nuk është rastësi që historia e ABI Bank përmban vetëm suksese, vit pas viti. Përputhja e plotë e interesave të klientëve, e punonjësve në degë, e drejtuesve të mesëm dhe të lartë, si dhe e aksionerëve të ABI Bank është një nga arsyet kryesore të këtij suksesi. Suksesi i klientëve sjell suksesin e punonjësve dhe suksesi i punonjësve sjell suksesin e aksionerëve.

Një nga arritjet tona më krenare është, që sot ABI Bank është institucioni Amerikan më i madh në Shqipëri, i të gjitha kohërave.

Aktualisht, ABI Bank gëzon një gjendje financiare optimale me tepriçë likuiditeti në para dhe në kapitale. ABI Bank është pozicionuar shumë mirë për të mundur rritjen e përfitueshmërisë së bankës.

Planet e ABI Bank për 2019 dhe në vazhdim janë shumë të thjeshta dhe të qarta.

Kultura e hapur dhe gjithëpërfshirëse e ABI Bank ka sjellë dhe do të sjellë një avantazh konkurrues të padiskutueshëm dhe afatgjatë. Kjo gjithëpërfshirje është veçanërisht e pasqyruar në angazhimin e ABI Bank për t'u dhënë mundësi të barabarta të gjithë punonjësve, pa u ndikuar nga gjinia. Vlen për tu përmendur se më shumë se gjysma e ekipit udhëheqës të ABI Bank përbëhet nga gjinia femërore. Në krahasim me bankat e tjera të ngjashme në Sistemin Bankar Shqiptar, ABI ka më shumë përfaqësim nga gjinia femërore në të gjitha nivelet e menaxhimit duke filluar nga Bordi Drejtues i saj, nga ekipi i Drejtuesve Ekzekutivë dhe deri tek Menaxherët e Korporatës e ata të Rrjetit të Degëve.

ABI krijon dhe do të vazhdojë të krijojë një shërbim butik të personalizuar si ndaj klientëve me rezultate të mira, ashtu edhe ndaj klientëve, që hasen me vështirësi financiare. ABI Bank mundëson integritet, pozitivitet, përkushtim, profesionalizëm dhe sofistikim tek marrëdhënia me klientët dhe pret të ketë të njëjtën përgjigje vlerash nga klientët. Kur këto vlera përputhen midis ABI dhe klientëve, ne jemi në gjendje të zgjidhim çdo problem financiar.

Një tjetër plan i rëndësishëm do të vazhdojë të jetë fokusi ynë në katër përparësitë e mbështetjes së komuniteteve, të cilat janë barazia ekonomike, barazia sociale, barazia gjinore dhe ajo shoqërore, jo vetëm për komunitet ku punojmë, por edhe në mbarë vendin.

ABI Bank beson se përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së jetës së gjithë shqiptarëve është përparësi kombëtare. Po ashtu, barazia sociale është një objektivi i rëndësishëm për të mundësuar një përfitim të gjithanshëm të shoqërisë. Siç është sipërpërmendur, barazia gjinore është gjithashtu një vlerë thelbësore të ABI Bank, të cilën e reflektojmë në monitorim e nivelit të pagave, titujve dhe promovimeve në bankë. Vullnetarizmi është një tjetër përparësi në ABI Bank. Populli ynë ka një traditë të mrekullueshme ndihme

dhe sakrifice. ABI do ta formalizojë dhe thellojë më tej këtë traditë duke marrë pjesë drejtpërdrejt me punonjësit e saj në aktivitete të ndryshme.

Për të gjitha këto arsye gjatë 2018, ABI Bank ka mbështetur aktivitete të ndryshme sociale, ekonomike dhe kulturore që kanë ndihmuar komunitetin në nevojë, për të plotësuar mungesat e tyre bazike, ashtu edhe grupet e tjera të veçanta të komuniteteve, për të pasuruar cilësinë e jetës. Të shumta kanë qenë edhe mbështetja e iniciativave që promovojnë traditën vullnetare.

ABI Bank beson se përputhja e interesave të aksionerëve me drejtuesit dhe punonjësit është me përfitim për të gjithë palët përfshi këtu dhe klientët. ABI është e vendosur që brenda një kohe të shkurtër të krijojë një plan të detajuar kompensimi të punonjësve në aksionet e kompanisë.

Punonjësit e ABI Bank, janë ata, të cilët me punën, përkushtimin, eksperiencën dhe njohuritë, ndikojnë drejtpërdrejtë në suksesin dhe në rezultatet e arritura deri tani.

Është synim parësor i ABI-t të ketë profesionistët më të mirë në treg. Tek ABI, atyre u ofrohen të gjithë instrumentet, hapësirat dhe mjedisi i nevojshëm për tu realizuar profesionalisht brenda dhe jashtë institucionit. ABI Bank e konsideron mision zhvillimin e mëtejshëm të këtyre profesionistëve, duke mundësuar programe trajnimi dhe konsulenca, nga trajnues të ndryshëm me eksperiencë në institucionet më të mira ndërkombëtare, për të përvetësuar cilësinë më të mirë të bankingut për klientët tanë.

ABI Bank është e përfshirë në iniciativën e krijimit të bursës së parë private në Shqipëri. Kjo do t'u mundësojë klientëve të ABI, por jo vetëm, që të përfshihen në historinë e suksesit të kompanive shqiptare, përfshirë edhe ABI Bank.

Jemi besimplotë se e ardhmja në ABI Bank do të vazhdojë të jetë premtuese dhe optimiste.

Edhe njëherë ju falenderojmë për mbështetjen dhe besimin e treguar të ABI.

QEVERISJA E KORPORATËS

Banka Amerikane e Investimeve SHA ka miratuar Kodin e Qeverisjes së Korporatës i cili është në përputhje me Statutin e Bankës dhe legjislacionin në fuqi.

Kjo rregullore përfshin rregullat e brendshme të Bankës, parimet dhe mekanizmat e kontrollit në bazë të të cilave banka organizohet dhe menaxhohet, duke miratuar një strukturë e cila është transparente për investitorët, duke njohur dhe respektuar të drejtat e personave të cilët ndikohen nga aktiviteti bankar dhe duke siguruar interesat legjitime të aksionarit të vetëm të Bankës. Principet bazë të Kodit të Bankës mbi Qeverisjen e Korporatës përshkruhen në vijim:

1.1. Të drejtat e aksionarit

Banka ka vendosur rregulla që garantojnë për aksionarin marrjen e informacionit të plotë mbi kushtet financiare të Bankës, si dhe mbi vendimet e Menaxhimit që ndikojnë ndjeshëm në veprimtarinë e saj. Aksionari i vetëm është një organ vendimmarrës i cili ushtron autoritetet e tij në përputhje me Statutin e Bankës, Kodin e Qeverisjes së Korporatave dhe dispozitat ligjore në fuqi.

1.2. Përbërja e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues përbëhet nga shtatë anëtarë të pavarur (jo ekzekutivë) dhe ekzekutivë, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Bankat në Shqipëri. Ndërthurja në arsim, përvojë dhe në fushat e ekspertizës së anëtarëve të Këshillit Drejtues është një faktor kyç në drejtimin e një banke Boutique.

1.3. Detyrat e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues, është një organ vendimmarrës, i cili i përgjigjet drejtpërdrejt aksionarit të vetëm. Këshilli Drejtues në përputhje me Statutin e Bankës dhe Kodin e Qeverisjes së Korporatave përcakton vizionin, misionin dhe strategjinë e Bankës. Qëllimi kryesor i Këshillit Drejtues është të sigurojë veprimtari të shëndetshme të kompanisë duke ndjekur rritjen afatgjatë të vlerës ekonomike të saj, duke monitoruar, drejtuar dhe kontrolluar ekzekutivin në përputhje me interesat e Aksionarit.

1.4. Kontrolli i Brendshëm

Banka ka një divizion të organizuar të Kontrollit të Brendshëm, i mbikëqyrur nga Komiteti i Kontrollit të Bankës. Ky i fundit, në përputhje me kërkesat ligjore, përbëhet nga tre anëtarë të pavarur, ekspertiza dhe monitorimi i të cilave është një ndihmë e vlefshme dhe e vazhdueshme për Bankën. Kryetari i Komitetit të Kontrollit është njëkohësisht anëtar i Këshillit Drejtues.

KËSHILLI DREJTUES¹:

KATHRYN SWINTEK

Kryetare e Këshillit Drejtues
(anëtare e pavarur)

ERNST REZZO SCHLAUCH

Zëvendës Kryetar i Këshillit Drejtues
(anëtar i pavarur)

MARK CRAWFORD

Anëtar i Këshillit Drejtues
(anëtar i pavarur)

ANDI BALLTA


Anëtar i Këshillit Drejtues
(Drejtor Ekzekutiv i Përgjithshëm)

ARMAND MUHARREMI

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Drejtor i Divizionit të Financës)

¹ 20 Dhjetor 2018; Lindita Rama dhe Richard Lukaj, të dy anëtarë të Këshillit Drejtues (anëtare të pavarur), nuk janë më pjesë e Këshillit Drejtues.

Komiteti	Qëllimi i Komitetit
Komiteti i Kredisë	Komiteti i Kredisë është organi më i lartë në Bankë, të cilit i është dhënë autoriteti për të aprovuar kreditë, duke operuar brenda ligjit dhe aktivitetit të bankës.
Komiteti i Çështjeve Delikate dhe Provigjionimit	Monitoron operacionet sensitive të Bankës dhe validon në bazë mujore dhe/ose tremujore koston e riskut lidhur me i) Standardet e Kontabilitetit Kombëtar dhe rregullave të Bankës së Shqipërisë dhe ii) IFRS
ALCO	Komiteti i Aseteve dhe detyrimeve ("ALCO") është përgjegjës për aprovimin e politikave dhe procedurave për menaxhimin e likuiditetit, pozicionimit të forex dhe riskun e normës së interesit, përpara aprovimit përfundimtar nga Këshilli Drejtues. Është gjithashtu përgjegjës për të rishikuar dhe monitoruar asetet dhe detyrimet lidhur me strukturën, afatin dhe përqendrimin, duke siguruar vlerësim të përshtatshëm të çmimit të investimeve të sigurisë, kredive dhe depozitave.
Komiteti i Kontrollit të Brendshëm	Komiteti i Kontrollit të Brendshëm është njësi që <ul style="list-style-type: none"> - Monitoron mekanizmin e kontrollit të brendshëm; - Koordinon funksionet e kontrollit, p.sh. Kontrollin e Përhershëm, Përputhshmërinë, Ligjorin, Kontrollin Financiar, Sigurinë e Informacionit, rrjedhimisht sistemin e kontrollit të brendshëm.
Komiteti i Sigurisë	Komiteti mbulon dy fusha kryesore: <p>A. Sigurinë Informatike</p> <p>B. Sigurinë Fizike</p> <p>Komiteti është përgjegjës për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbikëqyr përshtatshmërinë e kuadrit rregullator të brendshëm përkatësisht në fushat A. dhe B. - Përditësimet periodike mbi aktivitetin kontrollues dhe koordinimin e punës drejtuar sipas funksioneve përgjegjëse për drejtimin e dy fushave A. dhe B. (Emërimet: Oficer i Sigurisë Informatike dhe Drejtori i Departamentit të Sigurisë Fizike). - Trajtimin e çfarëdolloj projekti që i përket fushave A. dhe B., si dhe një mbikëqyrje të menaxhimit të marrëdhënieve me palë të treta ndihmëse të Bankës në fushat A. dhe B. - Mbikëqyrja e aplikimit të politikave të sigurisë brenda Bankës.
Komiteti i Teknologjisë së Informacionit	Komiteti synon të sigurojë jo vetëm një qeverisje të korporatave të shëndetshme, por gjithashtu të sigurojë formalizimin e nevojshëm të përgjegjësisë të njësive të biznesit si dhe IT në projektet zbatuese. Komiteti konsiderohet si organi më i lartë ekzekutues i kërkesave të qeverisjes IT. Përgjegjësitë kryesore të përfshira: <ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunim i ngushtë i IT me Njësitë e Biznesit në zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve - Aprovimi dhe monitorimi i buxheteve (p.sh. vjetor dhe 3 vjetor) - Metodologjia e menaxhimit të projekteve që nga lancimi (këtu përfshihet përgatitja e gjithë dokumentave të nevojshëm nga aprovimi deri në përfundim) - Rolet dhe përgjegjësitë e qarta të aktorëve (p.sh. ato të IT dhe Njësive të Biznesit) të përfshira në projekte dhe aktivitete - Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projekteve duke përfshirë caktimin e prioriteteve, vlerësimin e kostove dhe burimet njerëzore IT. - Monitorimi i operacioneve IT (nëpërmjet treguesve IT si incidentet, disponueshmërinë e sistemeve IT, ndryshimet, etj.)
Komiteti i Produkteve Dhe Aktiviteteve të Reja (NAP)	Ky komitet zyrtar mundëson që aktorët e përfshirë të punojnë paralelisht apo të bashkuar mbi kompozimin dhe zbatimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, të mblidhen zyrtarisht për të rënë dakord mbi kompozimin dhe zbatimin e produkteve dhe shërbimeve të reja. Përfshirja gjithëpërfshirëse e aktorëve të nevojshëm siguron gjithashtu zvogëlimin e përshtatshëm të çfarëdolloj risku të përfshirë. Rastet e biznesit duhet të aprovohen në Komitetin e NAP. Çmimet aprovohen në ALCO. Zbatimi teknik i produkteve dhe shërbimeve të reja trajtohet nga Komiteti i NAP.
Komiteti i Burimeve Njerëzore	Komiteti i Burimeve Njerëzore është organi zyrtar aprovues i Bankës. Ky komitet nxit dhe siguron zbatimin e përshtatshëm të Politikave dhe Procedurave të Burimeve Njerëzore, kulturës korporative dhe transparencën e procesit të marrjes së vendimeve me fokusin kryesor në zhvillimin profesional dhe personal të çdo punonjësi në Bankë.



BURIMET NJERËZORE



1 PUNONJËSIT JANË SHUMË TË RËNDËSISHËM...

Në ABI Bank, prioritet dhe element kyç i suksesit dhe në fokus të menaxhimit, janë punonjësit, mbështëtja, trajnimi, zhvillimi dhe vlerësimi i tyre. Si gjithmonë, stafi vazhdon të jetë pika jonë më e fortë.

Vetë qëllimi i punës në Divizionin e Burimeve Njerëzore është krijimi dhe ruajtja e një ambjenti pune tërheqës dhe profesionalisht stimulues.

Gjatë vitit 2018, punonjësit tanë janë karakterizuar nga aftësi dhe përpjekje të forta për të përmbushur standardet dhe objektivat e përcaktuara si dhe për të realizuar në kohë e më sukses strategjinë e Bankës.

Një rëndësi të veçantë për punonjësit e ABI Bank, për vitin 2018 kishte dhe Procesi i Vlerësimit të Performancës, i cili është një proces shumë transparent, duke mbajtur gjithmonë në fokus vlerësimin e punonjësve në planin 360°.

Ky proces garanton një vlerësim performance shumë efektiv dhe eficient, i cili i mundëson menaxherëve dhe eprorëve direkt të:

- Komunikojnë dhe qartësojnë objektivat e korporatës të punonjësit;
- Identifikojnë përgjegjësinë e çdo individit për përmbushjen e qëllimeve të korporatës;
- Adresojnë nevojat për përmirësim dhe zhvillim të punonjësve;
- Monitorojnë ecurinë dhe të sigurojnë feedback formal për punonjësit;
- Vlerësojnë në 360 gradë dhe të përmirësojnë performancën individuale dhe të korporatës.

Gjithashtu, politikat e bankës për punësim dhe trajtim në mënyrë të barabartë, i ka mundësuar 45 punonjësve të gjejnë punë afatgjatë apo afatshkurtër, brenda institucionit tonë.

2 PROCESI I TRANSFORMIMIT NË KËNDVËSHTRIMIN E BNJ

Fjala kyç përgjatë 2018 ka qenë pa dyshim fjala "BASHKËPUNIM"

Sot, flasim për ekipe të përbashkëta pune, komitete të përbashkëta, analiza të përbashkëta, objektiva të përbashkëta, kulturë të përbashkët korporative dhe sigurishtë edhe rezultate të përbashkëta.

Unifikimi i kulturës korporative, ka qenë dhe mbetet si një element shumë i rëndësishëm dhe në këtë kuadër në bashkëpunim me konsulentë e bashkëpunëtorë, janë kryer workshop-e me të gjitha njësitë e bankës me qëllim përfshirjen dhe angazhimin e të gjithë kolegëve në procesin e transformimit.

Gjithashtu, në mënyrë frekvente, u lançuan, monitoruan e analizuan me kujdes anketimet e "Team Barometer", për të evidentuar e parandaluar problematika, për të kuptuar e punuar mbi nevojat për përmirësim si edhe për të vlerësuar në kohë reale se sa i informuar ishte stafi për rolin dhe inputin e tij në procesin e transformimit, gjatë të gjitha hallkave.

Në kuadër të garantimit të bashkimit të suksesshëm edhe nga ana operationale, rëndësi dhe përkushtim shumë i madh iu kushtua edhe trajnimit të stafit. Trajnimi konsistoi në elementin teorik dhe praktik. Fokusi kryesor i trajnimit ishte Sistemi Qëndror i Bankës, Flexcube. Në këtë trajnim u përfshi i gjithë stafi i rrjetit të degëve, stafi operational dhe stafi në njësi të tjera si në Divizionet e Operacioneve, Financës, Administrimit të Kredive etj.

Gjithashtu në kuadër të forcimit dhe mbajtjes së kapaciteteve cilësore në Bankë, janë përmirësuar ndjeshëm pagat në disa nivele dhe janë rritur të gjitha pagat e nivelit minimal.

Sot ne besojmë në të njëjtat vlera që janë: pozitivitet, integritet, përkushtim, aftësi profesionale dhe sofistikim, operojmë në të njëjtin sistem, pra flasim të njëjtën gjuhë.

3 RESPEKTIMI I DIVERSITETIT

Banka Amerikane e Investimeve i jep mundësi të barabarta të gjithë kandidatëve dhe punonjësve pavarësisht nga moshja, gjinia, gjendja martesore, shtatzënia, statusi familjar, aftësia e kufizuar, raca, kombësia ose feja.

Divizioni i Burimeve Njerëzore, brenda fushës së tij të veprimit dhe kontrollit, garanton një angazhim maksimal në trajtimin në mënyrë të drejtë dhe të barabartë të individëve duke mos lejuar diskriminimin në asnjë moment.

4 TË DHËNAT E FUNDIT TË BOD PËR GENDER

Banka Amerikane e Investimeve është e vetmja bankë në sistemin bankar, bordin e së cilës e drejton një anëtare femër.

Gjithashtu koleget femra përbëjnë 71% të forcës punëtore të ABI Bank dhe 61% përsa i takon linjës së parë të menaxhimit.

Gjatë vitit 2018, janë realizuar në mënyrë të suksesshme disa anketime mbi barazinë gjinore dhe mbi elementë të përfaqësjes kulturore, në vazhdim të procesit të transformimit. Të dhënat e marra nga këta pyetësorë, kanë qenë dhe do të jenë për ne, një burim shumë i besueshëm informacioni, për të kuptuar nevojat e pritshmëritë si dhe për të përfituar ide apo sugjerime nga bashkëpunëtorët tanë më të mirë, nga stafi ynë, SEPSE NE JEMI NJË BANKË, NJË FAMILJE

Grada	Pozicioni	Banka Amerikane e Investimeve	
		HC	HC by Gender
G01	Staf mbështetës i sanitarëve	12	7 F (58%) 5 M (42%)
G02	Reception, Protokoll, Arkiva	3	3 F (100%) 0 M (0%)
G03	Specialist i ulët, Arkëtar	44	38 F (86%) 6 M (14%)
G04	Specialist, Shërbim Klientele	89	70 F (79%) 19 M (21%)
G05	Specialist i lartë 1, Analist, Shërbim Klientele i lartë	81	57 F (70%) 24 M (30%)
G06	Menaxher i Marrëdhënieve, BOS, Specialist i lartë 2, Analist i lartë, Drejtor i njësive, Mbikqyrës Agjencie	70	51 F (73%) 19 M (27%)
G07	Drejtor Dege, Zhvillues Biznesi, Drejtues Sektori	59	34 F (58%) 25 M (42%)
G08	Linja e dytë e Raportimit (Menaxherët e Divizioneve/Departamenteve), Drejtor Dege, Zhvillues Biznesi, Menaxher Rajonal	39	26 F (67%) 13 M (33%)
G9	Këshilltarë, Oficer Drejtues, Linja Direkte e Raportimit (Menaxher Divizioni/Departamenti)	22	13 F (59%) 9 M (41%)
G10	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv	1	

PROCESI

Një nga aktivitetet kryesore të 2018 ku u përfshinë të gjitha departamentet e Bankës dhe personeli ishte procesi i transformimit, me fjalë të tjera, udhëtimi ynë drejt një familjeje të madhe në ABI përmes kombinimit të praktikave dhe përvojave më të mira të ish-NBG Albania dhe ABI Bank.

Procesi i transformimit nisi disa javë para Mbylljes së Transaksionit me anë të organizimit të takimeve që synonin planifikimin e çështjeve lidhur me periudhën menjëherë pas blerjes dhe më pas me bashkimin e dy Bankave. Shumë nga menaxherët e lartë nga të dyja bankat ishin pjesë e këtyre takimeve. Përpjekjet e para kishin për qëllim krijimin e një Zyre për Menaxhimin e Procesit të Transformimit (TMO) dhe një listë detyrash të prioritizuara sipas afateve dhe ndjeshmërisë për secilin departament.

Që nga Korriku 2018 dhe deri më sot, kemi arritur të përfundojmë qindra detyra të cilat në fillim dukeshin të paplotësueshme. Disa nga më kryesoret përfshijnë:

1. Ekipet e rrjetit të degëve arritën të mbanin depozitat në nivelin e tyre historik duke trajtuar me sukses transferimin e pronësisë nga një bankë tradicionale Greke në ABI. Për më tepër, pas një bashkëpunimi të fortë në konceptimin dhe nisjen

TRANSFORMIMIT

- e fushatës së depozitave të verës, ata ishin në gjendje të rrisnin bazën e depozitave gjatë kësaj periudhe.
- Unifikimi i setit të produkteve që ofron Banka në një të vetëm së bashku me kontratat përkatëse, si dhe kushtet për të gjitha shërbimet bankare u finalizua deri në Tetor 2018.
 - Procesi i ndryshimit të imazhit të rrjetit të degëve, që përfshiu edhe një procedurë të zgjatur tenderi, u përfundua gjatë fundjavës përpara datës zyrtare të bashkimit më 1 Tetor 2018, pa asnjë gabim në saj të bashkëpunimit të ekipeve të Marketingut, Administratës dhe Rrjetit të Degëve. Ndryshimi i imazhit u përfundua në 26 degë dhe rreth 30 ATM të ish-NBGAL.
 - Departamentet e dhënies së kredisë dhe të menaxhimit të rrezikut punuan bashkërisht për të integruar të dy portofolet e kredisë në një të vetëm si dhe për të unifikuar mënyrën e klasifikimit të rrezikut dhe trajtimin e provizioneve.
 - U përmirësua rrjeti i degëve përmes bashkimit të disa prej tyre si në Tiranë ashtu edhe në qytete të tjera, duke arritur në një rrjet me 33 degë, përfshirë dhe 1 agjenci. Si pjesë e optimizimit të rrjetit të degëve, ne vazhdojmë të vlerësojmë më tej

- përmirësimin e pozicionimit tonë në Tiranë duke hapur degë në disa vendndodhje të reja.
- Departamenti i Financës arriti të përgatisë pasqyrat financiare të bashkuara të të dy Bankave për fundin e vitit 2018.
 - Departamenti i Burimeve Njerëzore ishte aktiv në përfundimin e sondazheve dhe seminareve të ndryshëm në të dyja bankat, në prezantimin e procesit të ri të vlerësimit së performancës dhe vendosjen e treguesve kryesorë të saj (KPI), në përfundimin e rregullimit/përmirësimit të pagave, etj.
 - Zhvendosja e të gjithë stafit të zyrave qendrore në një vend të vetëm në Kullën e Tiranës në Rrugën e Kavajës, një ndërmarrje e madhe logjistike.
- Procesi i transformimit me siguri nuk mund të përmblihet vetëm me rezultatet e renditura më sipër. Për momentin, është ende një përpjekje e vazhdueshme me fokus të veçantë tek kultura dhe mendësia e punonjësve. Sidoqoftë, gjithçka që është arritur në më pak se një vit, jo vetëm na ka dhënë një prezencë më të gjerë dhe më të qëndrueshme në treg, por na ka fuqizuar edhe sot, më shumë se kurrë, ti themi vetes, klientëve dhe aksionerëve tanë që ABI është me të vërtetë "Një bankë, Një familje".

PËRGJEGJËSIA SOCIALE



DREKA PER FEMIJET E POLICEVE TE VRARE

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti drekën për fëmijët dhe familjet e Martirëve të Policisë së Shtetit, organizuar më dhjetor me pjesëmarrjen e Ministrisë të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në veprimtari ishin të pranishëm 48 fëmijë dhe familjarë nga 226 familje. Gjatë veprimtarisë u shpërndanë gjithashtu ndihma për familjet dhe fëmijët.



DREKA E KRISHTLINDJES

Në Ditën e Krishtlindjes, Banka Amerikane e Investimeve iu bashkua nismës së lëvizjes Ecovolis, për t'i dhënë pak më shumë atyre që kanë më shumë nevojë për ne. Në sheshin "Nënë Tereza" bashkë me ABI Bank dhe shumë qytetarë apo kompani u mbledhën për të dhuruar për qindra njerëz në veshitë, në varfëri, në pamundësi. Në këtë ditë pati një përfaqësim masiv nga stafi i bankës, disa prej të cilëve morën dhe fëmijët me vete duke dhënë kontributin e tyre vullnetar.

DITA E FALENDERIMEVE

Kthyer tashmë në një traditë, ABI Bank festoi Ditën e



Falenderimeve, këtë festë tradicionale amerikane, së bashku me njerëzit në nevojë në Qendrën Sociale nr. 6 dhe pranë ambienteve të Kryqit të Kuq, në mensën sociale në Tiranë. Nën frymën e kësaj dite, stafi i ABI Bank u mbledh së bashku me përfaqësues të Dhomës Amerikane të Tregtisë dhe Bashkisë Tiranë për të qenë pranë atyre që kanë më shumë nevojë për ngrohtësi në këtë periudhë.



FUSHATA "BASHKË KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT"

Organizata YWCA në Shqipëri zhvilloi në datë 20 mars 2018, në Muzeun Historik një veprimtari kundër kancerit të gjirit në kuadër të dhjetë vjetorit të kësaj organizate me ambasadore Znj. Ermonela Jaho. Në takim folësit përmendën vështirësitë dhe diskriminimin, që ndeshin gratë me kancer gjiri në Shqipëri. Ambasadori amerikan në Shqipëri, Donald Lu, u angazhua që SHBA do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e shoqërisë shqiptare kundër kësaj sëmundje. Pranë ABI Bank shoqata ka hapur një numër llogarie për të mbledhur donacione për këtë fushatë.



ABI BANK SPONSOR I PËRGJITHSHËM I FLAMURTARIT

Flamurtari është shpallur zyrtarisht kampion i Shqipërisë në basketboll për femra për 2018. Pas ndeshjes, u zhvillua ceremonia e titullit kampion për vajzat e basketbollit. ABI Bank është sponsor i përgjithshëm i skuadrës së Flamurtarit në basketboll për femra, duke treguar se është gjithmonë prezent në histori suksesi.



ABI BANK MBËSHKET QENDRA SHËNDETËSORE NË DURRËS

Banka Amerikane e Investimeve mbështet qendrat shëndetësore të qytetit të Durrësit e cila me anë të stafit mjekësor dhe 18 studentë të infermierisë së Universitetit të Durrësit kanë qenë të pranishëm gjatë gjithë sezonit veror për të asistuar me ndihmën e parë dhe këshilla të nevojshme pushuesit e qytetit të Durrësit. 26 qendra shëndetësore ishin aktive gjatë sezonit veror në dispozicion të pushuesve në zonat turistike me shërbim 24h.



MARATONA E TIRANES

Banka Amerikane e Investimeve në 7 tetor ishte pjesë e organizimit të ½ Maratona e Tiranës 2018, veprimtaria sportive më e madh, që mbledhi mijëra njerëz nga Tirana, rrethe të tjera të Shqipërisë dhe shumë të huaj. ABI Bank ishte jo vetëm një nga mbështetësit kryesorë të saj, por e pranishme edhe me një skuadër të madhe të stafit.



MARATONA E VOSKOPOJES

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti edicionin e parë të Maratonës së Vrapimit Malor (trial run) në malet e Voskopojës, në datë 21 tetor, një veprimtari dyditore, që solli një ndërthurje të natyrës, vrapit dhe turizimit.



JAVA E PARASE KONKURSI "VIDEOJA MË E MIRË"

Banka Amerikane e Investimeve, në kuadër të Javës së Parasë, mbështeti konkursin: "Video më e mirë", duke ofruar çmimet për tre vendet e para të fituara nga nxënësit e shkollave të mesme, të cilët përcollën me origjinalitet temën: "Paraja: ç'të mbjellësh do të korrësh!"



RIT KOSOVO

Banka Amerikane e Investimeve në 15 maj ishte sponsor platin i mbërmjes gala në Prishtinë për mbledhjen e fondeve: "Mbështesni historinë e suksesit të radhës", organizim i R.I.T Kosovo, i vetmi institucion i arsimit të lartë në Kosovë që lëshon diploma Amerikane me njohje në gjithë botën. ABI Banka dha 3 bursa studimi për studentet e talentuar, por në vështiresi financiare. Më 14 nëntor 2018, RIT Kosovo mbajti për herë të tretë veprimtarinë fondmbledhëse, në Harvard Club në New York, SHBA. Kjo ngjarje, që ka për qëllim përkrahjen e të rinjve – "Mbështesni historinë e suksesit të radhës" – ishte një mundësi e shkëlqyer për diasporën shqiptare dhe miq të tjerë në SHBA për t'u informuar rreth RIT Kosovo. Banka Amerikane e Investimeve ishte sponsor i artë i kësaj veprimtarie.



ABI MBËSHTETET "RRUGA DREJT SUKSESIT"

Banka Amerikane e Investimeve ishte e pranishme dhe mbështetëse e veprimtarisë dyditore më të madhe të trajnimit në Shqipëri: "Rruga drejt Suksesit", nga Vasil Naçi, i cili në vitin e tretë të organizimit priti rreth 2,000 profesionistë të fushave të ndryshme.



ABI BANK KONFERENCA E 8-TË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE NË UNIVERSITETIN E DURRËSIT

4 dhe 5 maj 2018 u organizua Konferenca e 8-të Shkencore Ndërkombëtare nga Fakulteti i Biznesit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Temat e Konferencës ishin: Ekonomia e Qëndrueshme – Sfidat dhe Mundësitë, Menaxhimi dhe Sipërmarrja Inovative, Financa, Bankingu, Kontabiliteti dhe Industria e Sigurimeve. Banka Amerikane e Investimeve ishte e pranishme në këtë konferencë me qëllimin për të mbështetur sigurimin e arsimit cilësor gjithëpërfshirës për të gjithë



ABI BANK NË 'DASHURIA ËSHTË GJITHCKA'


Në dt. 17 Maj, në ambientet e Hotel Plaza u organizua mbrëmja gala e përvitshme "Love is All" e organizuar nga aktivistët e komunitetit LGBT në Tiranë. Në darkën gala ishin prezentë përfaqësues të Kabinetit Qeveritar, Ambasadori Amerikan Donald Lu, Ambasadorja e BE-së Romana Vlahutin dhe përfaqësues të tjerë të trupit diplomatik e organizatave ndërkombëtare.

Në kuadër të luftës kundër diskriminimit, Banka Amerikane e Investimeve mbështeti për të tretin vit këtë aktivitet bamirësie, misioni i të cilit ishte sigurimi i fondeve për vazhdimësinë e akomodimit, ushqimit, mbështetjes psikosociale, aftësisimit për jetën, edukimin dhe punësimin për të rinjtë LGBT, të cilët janë viktimë të abuzimit dhe diskriminimit dhe jetojnë pranë Qendrës "Streha".



ABI BANK PREZENT NË PANAIRIN E PUNËS DHE STUDIMIT 2018

Banka Amerikane e Investimeve merr pjesë për të tretin vit radhazi në Panairin e Punës dhe Studimit. ABI Bank ndjek me shumë vëmendje çdo mundësi trajnimi, specializimi dhe kualifikimi, si dhe ekspozita, konferenca e shkëmbime përvojash, të cilat kanë për qëllim zgjerimin e njohurive në punë, rritjen e eficiencës, si dhe kryerjen e detyrave të punonjësve në mënyrë sa më optimale. Gjithashtu rëndësi të veçantë i kushtojmë dhe programeve të intershipit dhe praktikës së studentëve, duke ju ofruar jo vetëm eksperiencë në zyrat qendrore por dhe praktikë në rrjetin e degëve.



PANAIRI I PUNËS 2018

U organizua në dt. 1 maj në sheshin Skënderbej, me një format ndryshe nga herët e tjera Panairi i Punës 2018, organizuar në një mjedis të hapur.

Banka Amerikane e Investimeve ishte prezente në këtë Panair, për të patur një ndërveprim të drejtpërdrejtë dhe më të gjerë me punëkërkuessit.

ABI BANK NE SPEED-DATING OJF-BIZNES

Banka Amerikane e Investimeve gjithmonë mbështetëse dhe promotore e nismave të rëndësishme sociale për shoqërinë tonë përkrah "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim" në iniciativën e saj për inkurajimin e zhvillimit të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri, konkretizuar në eventin e mbajtur ditën e premte dt. 8 Qershor në Sky Tower Hotel me të pranishëm përfaqësues të OJF-ve dhe bizneseve me qëllim përmirësimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe gjetjes së formave të ndryshme të partneritetit midis përfaqësuesve të sipërmarrjeve sociale dhe sektorit privat.



ABI BANK PJESË E PANARIT “SHQIPËRIA PUNON TOKËN”

Banka Amerikane e Investimeve ishte sponsor i panairit më të madh të bujqësisë në Shqipëri, që u zhvillua në 12 - 13 tetor 2018 në Sheshin “Nënë Tereza”. Ky është edicioni i dytë i panairit të bujqësisë, blegtorisë dhe agro-përpunimit, në festën e prodhimit vendas nën sloganin: “Shqipëria punon tokën”.




DITA E VERËS – ELBASAN

Mijera qytetarë u mblodhën për të festuar Ditën e Verës në qytetin e Elbasanit. Bashkë me banorët e qytetit dhe shumë vizitorë të ardhur nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, ishte dhe Banka Amerikane e Investimeve nëpërmjet stafit të degës së Elbasanit. Vizitorët e shumtë patën mundësi të njihnin Bankën nëpërmjet fletëpalosjeve të shpërndara, banerit të madh të varur në kalanë e qytetit që uronte për ditën e festës dhe gjatë koncerteve të organizuara në qytet.



Zhvillohet në 18 shtator, Festivali tre ditor i Inovacionit, i sjellë për herë të parë në vendin tonë. Eventi përkon me Samitin Botëror të Festivalit në Toronto, Kanada, e projektuar si “Festivali i së Ardhmes në Botë” organizuar nga Trend Hunter. Banka Amerikane e Investimeve, gjithmonë mbështetëse e zhvillimeve teknologjike dhe risive, është partnere dhe bashkëorganizatore e Festivalit të Inovacionit.



ABI BANK NE DITEN KOMBETARE TE TRASHEGIMISE KULTURORE

Banka Amerikane e Investimeve me rastin e “Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore”, mbështeti aktivitetet e organizuara në dt. 29 shtator:

1. Në qytetin e Beratit, vite të tëra historie, kulture dhe trashëgime u shpalosen nëpërmjet ekspozitave, panair artizanati dhe grupe muzikore nga qyteti i Beratit dhe Gjirokastrës, në sheshin qëndror “Teodor Muzaka” dhe Pedonalen e qytetit të Beratit.
 2. Shkodra priti Muzeun e Stilit Ethnovibe - nga tradita në moderne, në muzeun Marubi dhe Pedonalen e Shkodrës ku u bashkua tradita me modernen, nëpërmjet krijimeve të stilistëve të suksesshëm shqiptarë në botë, të frymëzuar nga perla të traditës.
- ABI Bank u përfaqësua nëpërmjet stafit të degëve duke treguar se është gjithmonë prezent në të tilla aktivitete që mbështesin dhe promovojnë vlerat e krijuara nga arti dhe kultura.



SIKUR MAMA

Në 23 gusht, në Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare, u organizua në Pallatin e Kulturës, Tepelenë: “Sikur Mama”, një veprimtari memoriale në mjediset e ish-Kampit famëkeq të Internimit në Tepelenë. Banka Amerikane e Investimeve ishte partnere e kësaj nisme, duke mbështetur jo vetëm financiarisht, por dhe duke i dhënë zë një historie nëpërmjet një përfaqësuesi të ABI Bank.



ABI BANK NË KORÇË "STACIONET E GJELBRA"

Banka Amerikane e Investimeve ishte sponsor i projektit të Bashkisë Korçë: "Stacionet e Gjelbra", i cili përfundoi më 6 tetor me Festën e Mollës, në fshatin Dvoran. Ky projekt solli gjatë gjithë verës veprimtari festive në disa fshatra të rrethit të Korçës, si: Voskopojë, Drenovë, etj., duke promovuar vlerat e trashëguara kulturore të secilës krahinë.



ABI BANK SPONSOR I PROJEKTIT "SMILE ALBANIA"

Lanohet në 24 maj në Amfiteatrin e Liqenit Artificial, projekti "Smile Albania". Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm të institucioneve shtetërore, shoqërinë civile dhe sektorin privat synon të ofrojë risi drejt eksplorimit të mundësive për të mbështetur turizmin shqiptar përmes angazhimit të të rinjve. 15 info point, 9 pika kufitare dhe 1'000 të rinj që mirëpresin turistët dhe japin informacion mbi vendin. ABI Bank është një nga sponsorat e projektit "Smile Albania" duke treguar mbështetjen e përhershme të projekteve të rëndësishëm që promovojnë vlerat e vendit tonë.



"TINGUJ KINEMAJE" ABI BANK MBESHTET

Banka Amerikane e Investimeve mbështet turin e koncerteve "Tinguj Kinemaje", të Orkestrës Simfonike të RTSH-së. Koncertet shëtitën në zona monumentale dhe turistike në disa qytete të Shqipërisë, duke përfshirë në repertorin e tyre muzikë nga filma të huaj dhe shqiptarë, performuar nga instrumentistët e talentuar të orkestrës Simfonike të RTSH-së. Muzika e filmave u shoqërohet me shfaqjen e fragmenteve të tyre në videoprojektor.



ABI BANK NE "SHKODRA JAZZ FESTIVAL"

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti "Shkodra Jazz Festival" në edicionin e nëntë në qytetin e Shkodrës. Plot 1 javë aktivitete në përkujtim e promovim të muzikës jazz. Në këtë edicion ka patur të ftuar nderi mjeshtra të mëdhenj të muzikës që me performancat e tyre kanë kënaqur e mahnitur publikun dhe për herë të dytë është organizuar dhe Rrok Akademy me masterclase nga artistë për të rinjtë e talentuar të qytetit.



ABI BANK në Festivalin MIK në Korçë

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti Festivalin MIK edicioni i parë i festivalit "Muzika Internacionale në Korçë", në plot 5 ditë aktivitete gjithëpërfshirëse në promovim të artit dhe kulturës. MIK Festival, sjellë me dashuri e sukses nga sopranoja Inva Mula dhe shumë artistë të tjerë mbështetur nga Banka Amerikane e Investimeve. Plot 5 netë arti, 5 netë inspiruese e të ngrohta korçare kanë sjellë në Korçë muzikantët me famë ndërkombëtare si violinisti Olen Cesari, pianisti dhe kompozitori Genc Tukiçi e plot 150 artistë të tjerë të cilët kanë performuar në ambientet e Teatrit "Andon Zako Cajupi" dhe te Pazari i Vjetër.



ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E DHOMËS AMERIKANE TË TREGTISË

Në 21 Mars u mbajt asambleja e përgjithshme e Dhomës Amerikane të Tregtisë "AMCHAM". Në këtë asamble, në prezencën e të gjithë anëtarëve të Dhomës Amerikane të Tregtisë, mbajti fjalën e tij përshëndetëse Ambasadori i Shteteve të Bashkuara, Z. Donald Lu duke theksuar rolin e rëndësishëm që kjo Dhomë duhet të luajë në vend. Banka Amerikane e Investimeve është sponsor platin i këtij aktiviteti duke ritheksuar kështu mbështetjen e vazhdueshme që ky institucion jep për investimet amerikane në vend duke qenë vetë ai investitori më i madh amerikan në Shqipëri.



10 VJETORI I ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi në 12 mars 2018, një takim me rastin e 10-vjetorit të themelimit të saj. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm përfaqësues të institucioneve qëndrore, institucione të pavarura dhe të sistemit të drejtësisë; nga trupi diplomatik; nga shoqëria civile; nga sektori privat; media, etj. Banka Amerikane e Investimeve ishte mbështetëse e partnere financiare e këtij aktiviteti.

ABI BANK DHE DHOMA AMERIKANE FESTOJNE 4 KORRIKUN

Për të tretin vit radhazi, Banka Amerikane e Investimeve ishte partneri kryesor i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Tiranë në organizimin e ceremonisë festive me rastin e festës së Pavarësisë së SHBA-ve. Pas fjalimeve hyrëse, ambasadori i SHBA në Shqipëri Z. Donald Lu hapi zyrtarisht festën me traditën e prerjes së tortës së bashkë me Drejtorin e Përgjithshëm të ABI Bank dhe drejtuesit e Dhomës Amerikane të Tregtisë.



Festimeve iu bashkua edhe stafi i ABI Bank, i cili shijoi atmosferën dhe aktivitetet e shumta. Banka Amerikane e Investimeve është Platinum Sponsor i Dhomës Amerikane të Tregtisë për të katërtin vit radhazi.

ART, SPORT, KULTURË



ABI BANK MBËSHTET KOMEDINË NJË "NJË ËNGJËLL NË KATIN E NJËMBËDHJETË"

Shkurt 2018 - "Një ëngjëll në katin e njëmbëdhjetë" është shfaqja e radhës në Teatrin Metropol me regji nga Stefan Çapaliku. Një komedi urbane, e cila i kalon kufijtë e postmodernes, në Teatrin Metropol - Qendra Kulturorë Tirana. ABI Bank edhe këtë vit është sponsor i përgjithshëm i Teatrit Metropol.



ABI BANK SPONSOR I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT "VIRTUOZËT"

ABI Bank është sponsor i përgjithshëm i programit Virtuozët në TV Klan. Ky program, patentë e kompanisë së njohur Endemol, ka si synim promovimin e talenteve të reja në fushat e muzikës klasike si balet apo kanto e vegla muzikore.

TULLA - OP OP

Banka Amerikane e Investimeve nën moton e mbështetjes së kulturës bashkëkohore mbarë shqiptare mbështet ekspozitën më të fundit që organizohet në ambientet e Tulla Cultural Center. Në këtë event ABI Bank ishte co-host së bashku me Tulla Cultural Center.



ABI BANK MBËSHËTET KONCERTIN RECITAL GAQI PIANO DUO

Në 22 mars 2018, në ambientet e Katedrales Ortodokse, dashamirësit e muzikës klasike patën mundësi të shijonin koncertin recital Gaqi Piano Duo: "Katër Duar, Një Piano". Recitali i vëllezërve Gaqi pati veçantinë e performancës artistike të dy artistëve në një piano të vetme, duke i sjellë publikut një repertor me vepra të shumëllojshme ndërkombëtare. Recitali i vëllezërve Gaqi mbështetet nga ABI Bank.



VERË DHE PORTOKALLE

Mbrëmje më shumë se argëtuese me spektaklin "Verë dhe Portokalle" në qytetet kryesore të Shqipërisë. "Verë dhe Portokalle", spektakli shëtitës më i madh i humorit nga trupa e "Portokallisë" së Top Channel, duke i dhuruar publikut mbrëmje "portokalli", ku nuk mungojnë notat e humorit, batutat e aktorëve të njohur të "Portokallisë". Spektakli me artistët më të mirë të humorit, mundësohet nga Banka Amerikane e Investimeve!



ABI BANK NË GJIROKASTËR

29 qershor 2018 - Qyteti i Gurtë i Gjirokastrës ishte nën pushtetin e interpretimit dinjitoz të të madhit Mirush Kabashi me monodramën "Apologjia e Vërtetë e Sokratit",

duke përcjellë emocione në çdo cep të Odeonit magjik. Organizimi i këtij eventi kulturor i modelit "Gala" në periudhën me frekuentimin më të lartë të turistëve vendas dhe të huaj u mbështet nga Banka Amerikane e Investimeve, e cila ka qëllimin për të rritur ndikimin e artit dhe kulturës në shoqëri. Pjesë e këtij aktiviteti ishte dhe stafi i degës Gjirokastër të cilët përfaqësuan dhe prezantuan bankën këtë mbrëmje.



ABI BANK PREZENT NË NJË REALITY SHOW

Qershor 2018 - Hosteli më argëtues në Shqipëri. "Hostel by Anabel" është një bashkëprodhim i Anabel Entertainment dhe INTV, një televizion modern, shumë energjik dhe plot pasion me një target grup rinor. Autorja e programit është Dalina Buzi dhe ngjarjet zhvillohen në newsroom-in e Anabel. Një program argëtues që shtrihet midis reality show dhe televizionit tradicional, frymëzuar tërësisht nga historitë dhe e përditshmja.

ABI Bank si sponsor i këtij programi tregon se është në mbështetje të programeve të ndryshme artistike universale që shtrajnë rrugën drejt një mirëkuptimi më të gjerë kulturor.



ABI BANK NË FEST FOLK 2018

13 qershor 2018 - Është organizuar në dt. 13 Qershor, Festivali i Interpretuesve të Këngës Popullore për fëmijë në qytetin e Fushë Krujës. Ky është viti i 18 i festivalit për fëmijë i cili ka mbledhur qindra fëmijë të moshave të ndryshme nga zonat e veriut si dhe nga Maqedonia e Kosova. Fituesit e festivalit janë përzgjedhur nga juria e përbërë nga emra të mirënjohur artistësh si Roza Anagnosti, Edit Mihali etj. ABI Bank është gjithmonë mbështetës i edukimit të brezit të ri, duke promovuar vlerat e krijuara nga arti dhe kultura.



ABI BANK E VETMJA BANKË PREZENTE NË KONCERTET QË CELËN SEZONIN VEROR NË TIRANË!

1 dhe 3 qershor- Dy koncerte të mëdha në qendër të Tiranës ishin një sukses i vërtetë! Ermal Meta ditën e premte dhe Rita Ora ditën e dielë, ndezën sheshin Skënderbej në Tiranë. Banka Amerikane e Investimeve, si një partnere e përhershme e kulturës mbështeti edhe këtë radhë dy histori suksesi shqiptare!



ABI BANK TANI DHE NE KINEMATOGRAFI

Është prezentuar zyrtarisht në dt. 21 maj, filmi italian "Rimetti a noi i nostri debiti", në Kinemanë Millenium. Një dramë italiane që rrëfen historinë e një burri të papunë që lufton të paguajë borxhet e akumuluar ndër vite. Filmi është bashkëprodhim italo-shqiptar-zviceran-polak. Bashkëprodhuesi italian "Luna srl", Lotus Production, shqiptares Skan-dal Production etj. ABI Bank është një prej sponsorave për realizimin e filmit "Rimetti a noi i nostri debiti"! Filmin do të shfaqet në kinema dhe shumë shpejt edhe në kanalet e Digitalb dhe RTSH.

ABI BANK SPONSOR I PËRGJITHSHËM I TEATRIT TË DURRËSIT

Është inaguruar në dt. 4 maj, "Hall of Fame" në teatrin Aleksandër Moisiu Durrës. "Hall of Fame"- tenton të përfshijë aktivitetet e 65 viteve të Teatrit "Aleksandër Moisiu". Fotot e aktoreve të cilat kanë shënuar këtë teatër apo shfaqjet më të famshme të tij. Ky aktivitet ka patur një pjesëmarrje të gjerë nga përfaqësues të Bashkisë së Durrësit, Teatrit "Aleksandër Moisiu", publikut të gjerë dhe përfaqësues nga ABI Bank. Drejtori i Teatrit, Z. Bashkim Hoxha, ndër të tjera ka prezantuar dhe partneritetin me



Bankën Amerikane të Investimeve e cila do të jetë sponsor i përgjithshëm i Teatrit "Aleksandër Moisiu". Inagurimi i Teatrit është shoqëruar edhe me premierën "Komedia që shkon për drejt" me aktorë të mirënjohur si Bujar Asqeriu, Romir Zalla, etj.



ABI BANK SPONSOR I PËRGJITHSHËM I MASTER CHEF JUNIOR

Fëmijë të vegjël – Sfida të mëdha! 12 javë ku qenë në garë shefa të vegjël të kuzhinës në ekranin e RTSH. Fëmijë të talentuar dhe të apasionuar pas gatimit, dhuruan emocione të bukura në Master Chef-in e parë Shqiptar për fëmijë. Ky program u mbështet nga ABI Bank, gjithmonë prezent në programe të tilla që transmetojnë optimizëm dhe frymën e garës.



ABI BANK SPONSOR I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT "DANCING WITH THE STARS"

Prill - maj 2018 - ABI Bank ka mbështetur programin më të dashur në TV Vizion Plus, patentë e BBC, me pjesëmarrjen e yjeve të televizionit shqiptar. Argëtim, muzikë, vallëzim. Një atmosferë festive, një konkurs i fortë dhe një juri kërkuese ndaj të bukurës dhe perfekte.



MBREMJE MUZIKORE ME VEPRATË TONIN HARAPIT

Universiteti i Arteve, në kuadrin e vlerësimit të figurave të artit dhe kulturës ka organizuar veprimtari përkujtimore në nderim të kompozitorit artist i popullit Tonin Harapi. Pianist, krijues, pedagog, kritik e publicist, Tonin Harapi ushtroi përmbi 40 vjet një veprimtari të gjerë e të shumëanëshme artistike. Java e aktivitetëve në nder të kompozitorit të mirënjohur u cel në dt. 2 prill me koncertin e parë me vepra instrumentale të zgjedhura nga krijimtaria e tij. Banka Amerikane e Investimeve është mbështetëse e këtyre aktivitetëve si një partnere e përhershme e veprimtarive kulturore dhe artistike.



JONIDA PODCAST - COURTESY OF ABI BANK

Jonida Podcast është projekti më i ri mbështetur nga ABI Bank. Një bibliotekë intervistash ku dëgjohen rrëfime, biseda, intervista ekskluzive dhe interesante me personazhe të njohur ose të panjohur. Banka Amerikane e Investimeve është sponsor ekskluziv i këtij projekti ambicioz dhe bashkëkohor.



ABI BANK NË KONCERTIN VEROR TË ORKESTRËS DHE KORIT TË TË RINJVE TË TIRANËS

Në dt. 23 korrik salla e Katedrales Ortodokse ka mirëpritur koncertin veror të Orkestrës dhe Korit të të rinjve të Tiranës. Këngëtarë të rinj, orkestra e harqeve, kori i të

rinjve, e fëmijë që punojnë në SoundProduction janë ngjitur në skenë në një performancë live. Grupi i urbanArt performoi me një instalacion stencil në një telajo të madhe me temën kundër bullizmit. Dhe jo vetëm, tenori shqiptar me famë botërore Saimir Pirgu ishte surpriza e mbrëmje së djeshme. Banka Amerikane e Investimeve përkrah këtë aktivitet të freskët, original që promovon talentet e reja.



ABI BANK NE POGRADEC

Mbrëmja poetike me "Nderin e Kombit" Mirush Kabashi në interpretimin e Koncertit Recital Poetik "Pogradec o Enkelana", ishte pjesë e aktivitetëve me rastin e celjes së sezonit turistik në qytetin e Pogradecit. Organizimi i këtij aktiviteti artistik u mbështet e nga Banka Amerikane e Investimeve.



SHPAT DEDA NE TURNEUN E "AMBEL E THARTE"

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti turneun e koncerteve "Ambël e Thartë", të këngëtarit nga Kosova Shpat Deda. Kalaja e Gjirokastrës, Muzeu i Pavarësisë në Vlorë, Manastiri i Shën Mërisë në Apolloninë e Fierit kanë qenë disa nga monumentet e kulturës të zgjedhura në këtë turne për të përcjellë emocionet e koncertit të Shpat Deds, këngëtar shumë i dashur për publikun shqiptar. Banka Amerikane e Investimeve është mbështetëse e turneut "Ambël e Thartë", koncerte të cilat transmetojnë emocione artistike dhe vlerat e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë.


DREN ABAZI DHE ZIG ZAG ORKESTRA NE AMFITEATRIN E TIRANES

27 shtatori priti kantautorin nga Kosova Dren Abazi dhe Zig Zag Orkestra në Amfiteatrin e Tiranës, ora 20:00. Këngëtari i mirënjohur ngriti skenën e amfiteatrit me këngë të përzgjedhura nga albumi "Mes yjesh" dhe "Afterparty", duke e konsideruar koncertin si aktivitet kulturor dhe jo vetëm argëtues. Banka Amerikane e Investimeve është mbështetëse e këtij aktiviteti jo vetëm për të promovuar artistë të rinj të trevave Shqiptare por dhe për ti dhënë jehonë vendeve të cilat janë restauruar rishtazi dhe rrisin cilësinë e jetës së komunitetit si Amfiteatri i Liqenit në Tiranë.



ABI BANK MBESHTET PROGRAMIN "FAMILJA"

ABI Bank vazhdon mbështetjen e shfaqjeve më interesante në televizionet më të mira kombëtare. Familja është programi më i ri i sjellë në ekranin e TV Klan. Energji, lojra, adrenalinë dhe të qeshura pafund tek Familja!



ABI BANK NE KONCERTIN "MISA CRIOLLA"

Koncerti me titull "Misa Criolla" vjen në Amfiteatrin e Katedrales Ortodokse në orën 19:00.

Kjo vepër angazhon një numër të madh muzikantësh të rinj e profesionistë të Universitetit të Arteve. Rrugëtimi muzikor i kësaj mbrëmje sjell më pas kompozitorët Mozart dhe Dvorak në interpretimin e muzikantëve të Orkestrës Shqiptare të Dhomës. Koncerti mbështetet nga ABI Bank!



TAKIMI MBAREKOMBETAR I TEATRIT PROFESIONIST "KADRI ROSHI"


Takimi Mbarëkombëtar i Teatrit Profesionist "Kadri Roshi" zhvilluar për herë të parë në Gjirokastër ngjiti në skenën e teatrit "Zihni Sako" një sërë aktorësh të cilët u vlerësuan nga Juria profesioniste ku për 7 netë radhazi ndoqi interpretimin e trupave teatrore pjesëmarrëse.

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti financiarisht cmimet e akorduara për shfaqjen, regjinë, skenografinë dhe aktorët më të mirë dhe ndarja e tyre në natën finale u bë nga stafi i degës në Gjirokastër.



ARTI SHQIPTAR NE VATIKAN

Mbrëmjen e datës 19 Nëntor në Vatikan Papa Françesku priti një audiencë të veçantë qytetare shqiptare me përfaqësues të shtetit dhe shoqërisë, të besimeve fetare në Shqipëri, intelektualë e artistë. Audiencia për Heroin Kombëtar pasoi atë 50 viteve më parë sërish në nderim të heroit kombëtar, atletit i krishterimit Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Pas audiencës me Papa Françeskun, emrat e mëdhenj shqiptarë të artit dhe sportit Inva Mula, Genc Tukici, Dua Lipa, Ermal Meta, Ramë Lahaj, Lorik Canaj etj, ishin së bashku në një koncert në Romë. Mbështetur nga Banka Amerikane e Investimeve "Të bashkuar në muzikë dhe kujtimin e Skënderbeut", artistët shqiptarë në skenat botërore sollën përmes një repertori elitari nderimin për heroin kombëtar dhe kombin që mban sot veprën e tij.



ABI BANK SPONSOR GJENERAL I FEST 57

Banka Amerikane e Investimeve është sponsor gjeneral i Festivalit të Këngës në RTSH – Fest 57, mbajtur në datat 21 – 23 dhjetor në Pallatin e Kongreseve.

DEGËT

ABI - Zyrat Qendrore dhe Dega Qendrore

Rr. Kavajes Nd. 27/1, Tirane

ABI - Dega Biloku "Premier"

Rr. I.Qemali, Samos Tower, Tirane

ABI - Dega "Bajram Curri"

Rr. B.Curri, Pall. 13/1, Tirane

ABI - Dega "Pajtoni"

Autostrada Tirane-Durrres, km 6, Tirane

ABI - Dega "Rr. Bardhyl"

Rr. Gogo Nushi, Nr. 11/a, Tirane

ABI - Dega "Komuna"

Rr. K.Parisit, Kullat Tirhino, Tirane

ABI - Dega "Prane Ambasadave"

Rr. Kavajes, P.114/1, ish farmacia nr.9, Tirane

ABI - Dega Biloku

Rr. Sami Frasheri, Pallati Teknoprojekt, Tirane

ABI - Dega "Pazari Ri"

Rr. Luigj Gurakuqi, pallati me kollona, Tirane

ABI - Dega "Sheshi Shtraus"

Rr. Qemal Stafa, Sheshi Shtraus, Tirane

ABI - Dega "Parku"

Rr. Kavajes, prane ish parkut te autobuzave, Tirane

ABI - Dega "Kombinati "

Rr. Llazi Miho, P.6, Shk.1, Ap.2, Tirane

ABI - Dega "Rr. Dibres"

Rr. Dibres, perballe Vila Goldi, Tirane

ABI - Dega "Rr. Elbasanit"

Blv. Bajram Curri (prane shkolles se baletit, tek stacioni i autobuzit), Tirane

ABI - Dega "Bulevard", Durres

Rr. Tregtare, Durres

ABI - Dega "Radesa", Durres

Lagja Nr.5, Rruga Deshmoret, Durres, Radesa Center, Durres

ABI - Dega Kavaje

Blvd. Qendror, Kavaje

ABI - Dega Elbasan

Lagja "Qemal Stafa", Rr. 11 Nentori, Elbasan

ABI - Dega "Turizmi", Elbasan

L. "Luigj Gurakuqi", Blv. Qemal Stafa (tek Hotel Skampa), Elbasan

ABI - Dega Fier

Lagjia K.e Pezes, Sheshi Fitorja, Fier

ABI - Dega Lezhe

Sheshi Qendror, Lezhe

ABI - Dega Lushnje

Shetitorja Kongresi i Lushnjes, (prane Postes Shqiptare), Lushnje

ABI - Dega Shkoder

L. "Vasil Shanto", Rr.13 Dhjetori, Nr.270, Shkoder

ABI - Dega "Skele" Vlore

Qendra Riviera, Skele, Vlore

ABI - Dega "Shetitorja" Vlore

Blv. Kryesor, Parku Rinia, Vlore

ABI - Dega "Qender" Sarande

Sheshi Skenderbej, Sarande

ABI - Dega " Rr. Skenderbeu", Sarande

L.1, Rr."Skenderbeu", Nr.50, (prane Kishes Ortodokse), Sarande

ABI - Dega Gjirokaster

Lagja "18 Shtatori" (prane Spitalit), Gjirokaster

ABI - Agjensia Livadhja

Livadhja, Sarande

ABI - Dega Pogradec

Rr. "Reshit Collaku", (perballe Hotel Turizmit), Pogradec

ABI - Dega Berat

Blv. Kryesor, Lagjia 28 Nentori, Berat

ABI - Dega Korce

Rruga "Sotir Gura" Nr. 1, Lagja 2, Korce

ABI - Dega Kukës

Rr. "Dituria", Lagjia Nr.4, Kukës

ABI - Dega Bilisht

Rr. Nacionale Bilisht-Kapshtice, (ne dalje te qytetit), Bilisht

ATMIN & OFF-SITE

Berat

Blv. Kryesor, Lagjia "28 Nentori",
Berat
in-Branch

Bilisht

Rr. Nacionale Bilisht - Kapshtice,
Perballe Stacionit te Komunes
Miras, Bilisht
in-Branch

Durres

Rruga Tregetare,
in-Branch

Durres

Blv. Kryesor (Dyrrah) e P. Meksi. P.
157, Durres
in-Branch

Elbasan

Lagja "Qemal Stafa", Rr.11 Nentori
in-Branch

Fier

L. K.e Pezes, sheshi Fitorja
in-Branch

Gjirakaster

Lagja "18 Shtatori"
in-Branch

Kavaja

Bulevardi Kryesor, Lagja 3, Kavaje
in-Branch

Korce

Blv. Republika, Korce
in-Branch

Kukes

Rr. "Dituria", Lagjia Nr. 4, Kukes
in-Branch

Lezha

Qender
in-Branch

Lushnja

Shetitorja "Kongresi i Lushnjes",
Prane Postes Shqipetare, Lushnje
in-Branch

Pogradec

Rr. "Reshit Collaku", Lagjia 2,
Perballe Hotel Turizmit
in-Branch

Saranda

Rr. "Skenderbej", Nr. 50, Prane
Kishes Ortodokse, Sarande
in-Branch

Saranda

Livadhja
in-Branch

Shkodra

Lagjia "Vasil Shanto", Rr. "13
Dhjetori", N. 270, Shkoder
in-Branch

Tirana

Rr. e Kavajes, 59
in-Branch

Tirana

Ing. Ndertimit

Tirana

Samos Tower, Rr. Ismail Qemali
in-Branch

Tirana

Rr. "Bajram Curri", Prane
Shkolles se Baletit
in-Branch

Tirana

Bulv. B. Curri
in-Branch

Tirana

Autostrad. Tir-Dur, KM6 Pajton
in-Branch

Tirana

Rr. "Qemal Stafa", Sheshi
Shtraus
in-Branch

Tirana

Rr. komuna e Parisit
in-Branch

Tirana

Rr. e Dibres, Perballe "Vila
Goldi"
in-Branch

Tirana

Rr. "Qemal Stafa", Sheshi
Shtraus
in-Branch

Tirana

Rr. "Kavajes" P. 114/1
in-Branch

Tirana

Rr. "Luigj Gurakuqi", Pallati
me Kollona
in-Branch

Tirana

Rr. "Sami Frasherit", Pallati
Teknoprojekt
in-Branch

Tirana

Rr. e Kavajes, Prane Ish
"Parkut Te Autobuzeve"
in-Branch

Tirana

Rr. "Llazi Miho", P. 6, Shk. 1,
Ap. 2, Kombinatat
in-Branch

Vlora

Blv. Kryesor, Parku
Rinia, Vlora
in-Branch

Vlora

Blv. Kryesor, Parku
Rinia, Vlora
in-Branch

Durres

Pap Metal, Shkozet, Durres
Off-site

Durres

Bulevardi
Off-site

Durres

ATM Durres Spitali
Off-site

Kavaja

Luz i Vogel
Off-site

Korce

Voskopoje
Off-site

Tirana

Sky Tower
Off-site

Tirana


Blv. "Zogu i Pare", Prane
Njesise Bashkiake Nr.8
Off-site



BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Pasqyrat Financiare të Veçanta
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(me raportin e audituesit të pavarur)



Raporti i auditueseve të pavarur	28
Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar	30
Pasqyra e fitim humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërshirëse	31
Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapital	32
Pasqyra e veçantë e flukseve monetare	33
1 Subjekti raportues	34
2 Bazat e përgatitjes	34
3 Ndryshime në politikat kontabël dhe shënimet shoqëruese	35
4 Politikat kryesore kontabël	36
5 Standardet e reja dhe interpretime ende të pamiratuara	54
6 Standardet e lëshuara dhe në fuqi për periudhën vjetore	53
7 Menaxhimi i rrezikut	54
8 Përmbledhje e vlerësimeve dhe gjykimeve kontabël	76
9 Vlera e drejtë e aktiveve dhe pasiveve financiare	98
10 Analiza e aktiveve, detyrimeve dhe kapital sipas maturitetit të mbetur	81
11 Mjetet monetare dhe të ngjashme	82
12 Hua dhe paradhënie bankave	82
13 Investime financiare në letra me vlerë	82
14 Huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve	85
15 Qira financiare	93
16 Aktive afatgjata materiale	94
17 Aktive afatgjata jo-materiale	95
18 Inventari dhe mjete të tjera	95
19 Aktive të vlefshme për shitje	95
20 Investime në pjesëmarrje dhe filiale	96
21 Detyrime ndaj bankave	96
22 Detyrime ndaj klientëve	97
23 Borxhi i varur	98
24 Aktive tatimore të shtyra	98
25 Provizione të tjera	99
26 Detyrime të tjera	99
27 Kapitali aksionar	99
28 Rezervat	100
29 Të ardhura neto nga interesat	101
30 Të ardhura neto nga komisionet	101
31 Të ardhura të tjera, neto	101
32 Shpenzimet e personelit	102
33 Shpenzime të tjera administrative	102
34 Tatim fitimi	102
35 Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara	103
36 Çështje ligjore	103
37 Angazhimet për qiratë dhe shpenzimet për qiratë operative	103
38 Transaksionet e palevë të lidhura	104
39 Ngjarje pas datës së bilancit	105



Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NUIS: K619110121
Ibrahim Rugova Str, Sky Tower, 6th floor
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Banka Amerikane e Investimeve sh.a

Raporti mbi auditimin e pasqyrave financiare të veçanta

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të Banka Amerikane e Investimeve sh.a (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2018, si dhe pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e veçantë të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e veçantë të flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të veçanta, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës më 31 dhjetor 2018, si dhe të rezultatit të saj financiar dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta të raportit tonë*. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël* ("Kodi i BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri ("Kodi IEKA"), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Veçanta

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta që nuk përmbajnë anomali materiale, ofrtë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të veçanta në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të veçanta.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare të veçanta, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të veçanta, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të veçanta, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të veçanta paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Banka Amerikane e Investimeve sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Accountants

25 shtator 2019
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor

Mario Vangjel

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018 Lekë '000	31 dhjetor 2017 Lekë '000
Aktivet			
Mjete monetare dhe të ngjashme	13	12,730,713	6,778,201
Hua dhe paradhënie për bankat	14	5,950,972	2,718,602
Investime financiare – VDATGJ	15	19,217,970	-
Investime financiare me kosto të amortizuar	15	10,124,370	-
Letra me vlerë të vendosjes	15	-	10,803,880
Letra me vlerë të investimit	15	-	7,879,715
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	16	24,721,153	9,285,162
Qira Financiare	17	55,835	78,499
Aktive afatgjata materiale	18	857,285	528,020
Aktive afatgjata jo-materiale	19	142,858	157,634
Të drejte tatimore të shtyra	26	25,482	2,226
Inventari dhe mjete të tjera	20	3,937,203	2,770,739
Aktive të vlefshme për shitje	21	10,075	10,075
Investime në pjesëmarrje dhe filial	22	41,375	21,250
Totali i aktiveve		77,815,291	41,034,003
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	23	1,343,237	1,056,830
Detyrime ndaj klientëve	24	65,670,499	34,946,297
Detyrime të tjera	28	1,164,227	286,647
Provizione të tjera	27	31,472	29,312
Detyrime tatimore të shtyra	26	167,577	88,650
Borxhi i varur	25	373,059	800,899
Totali i detyrimeve		68,750,071	37,208,635
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	29	3,085,459	7,983,629
Rezerva ligjore dhe të tjera	30	4,184,123	57,162
Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	30	912,300	505,230
Fitim/ (Humbja) e akumuluar		883,338	(4,720,653)
Totali i kapitalit aksionar		9,065,220	3,825,368
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		77,815,291	41,034,003

Shënimet shpjeguese bashkëngjitur nga 1 deri në 41 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Viti i mbyllur më	Viti i mbyllur më
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
	Lekë '000	Lekë '000
Të ardhura nga interesat	1,997,520	1,566,134
Shpenzime për interesa	(491,742)	(404,330)
Të ardhura nga interesat, neto	1,505,778	1,161,804
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	167,794	138,060
Shpenzime për tarifa dhe komisione	(49,721)	(34,994)
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet, neto	118,073	103,066
Rezultati neto nga veprimet me valutat	(24,471)	42,235
Të ardhura të tjera operative, neto	5,405	81,405
Të ardhura operative	(19,066)	123,640
Rimarje nga zhvlerësimi i aktiveve financiare, neto	470,563	172,537
Humbje nga zhvlerësimi i aktiveve financiare, te tjera	(34,466)	-
Shpenzime personeli	(540,669)	(400,157)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(107,321)	(105,510)
Shpenzime të tjera administrative	(686,874)	(460,469)
Shtesë provizionit për rreziqe dhe shpenzime	(27,692)	(1,236)
Totali i shpenzimeve	(926,459)	(794,835)
Fitimi neto, përpara tatim fitimit	678,326	593,675
Shpenzimi i tatim fitimit	(109,295)	(3,281)
Fitimi neto e vitit	569,031	590,394
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		
<i>Zëra që janë ose mund të rriklasifikohen në pasqyrën e fitim humbjeve</i>		
Ndryshimi në vlerën e drejtë të instrumentave financiarë, (VDATGJ) neto nga tatimi mbi fitimin	357,750	-
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes, neto nga tatimi mbi fitimin	-	35,155
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto	357,750	35,155
Totali i të ardhurave të tjera përmblendhëse për vitin, neto	926,781	625,549

Shënimet shpjeguese bashkëngiitur nga 1 deri ne 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë nënshkruar në emër të Bankës më 30 korrik 2019 nga:

Andi Ballta
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



Armand Muharremi
Drejtori Divizionit të Financës

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore dhe të tjera	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitim/ (Humbja) e akumuluar	Totali
	Lekë '000	Lekë '000	Lekë '000	Lekë '000	Lekë '000
Gjëndja me 1 janar 2017	7,708,537	57,162	470,075	(5,311,047)	2,924,727
Fitimi i vitit	-	-	-	590,394	590,394
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	35,155	-	35,155
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	35,155	590,394	625,549
Veprimet me aksionarët të regjistruara direkt në kapital					
Kontributi i aksionarëve nëpërmjet konvertimit të borxhit të varur (shënimi 22)	275,092	-	-	-	275,092
Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	275,092	-	-	-	275,092
	7,983,629	57,162	505,230	(4,720,653)	3,825,368
Gjëndja më 31 dhjetor 2017					
Impakti në aplikimin e SNRF 9	-	-	49,320	3,578	52,898
Gjëndja e modifikuar pas aplikimit të SNRF 9	7,983,629	57,162	554,550	(4,717,075)	3,878,266
Fitimi i vitit	-	-	-	569,031	569,031
Ndryshimi në zhvlerësimin e letrave me vlerë	-	-	357,750	-	357,750
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	357,750	569,031	926,781
Veprimet me aksionarët të regjistruara direkt në kapital					
Kontributi i aksionarëve nëpërmjet konvertimit të borxhit të varur (shënimi 22)	378,158	-	-	-	378,158
Përvetësimi i fitimit në rezervën ligjore	-	244,946	-	(244,946)	-
Rezerva nga bashkimi	-	3,882,015	-	-	3,882,015
Zvogëlimi i kapitalit për humbjet e akumuluar	(5,276,328)	-	-	5,276,328	-
Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	(4,898,170)	4,126,961	-	5,031,382	4,260,173
Gjëndja më 31 dhjetor 2018	3,085,459	4,184,123	912,300	883,338	9,065,220

Shënimet shpjeguese bashkëngjitur nga 1 deri në 41 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E VEÇANTË E FLUKSEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Viti i mbyllur më	Viti i mbyllur më
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
	Lekë '000	Lekë '000
Fitimi përpara tatimit	678,326	593,675
Rregullime për:		
Amortizimi dhe zhvlerësimi	18,19	107,321
Fitimi nga zhvlerësimi neto i huave dhe paradhënieve për klientët	16,17	(470,563)
Humbja nga zhvlerësimi neto i zërave jashtë bilancit	27	-
Zhvlerësimi neto i aktiviteteve financiare, përvec huave		34,466
Humbja neto nga zhvlerësimi i provizioneve të tjera operative	27	27,692
Të ardhura neto nga interesat	31	(1,505,778)
Diferencat nga kursi i këmbimit		24,471
Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata	18,19	-
		4,665
Ndryshime në:		
Hua dhe paradhënie ndaj bankave	14	(3,135,281)
Rezervën e detyrueshme	14	(151,416)
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	16	3,203,354
Qiraja Financiare	17	21,922
Detyrime ndaj bankave	23	(139,607)
Detyrime ndaj klientëve	24	819,827
Inventari dhe aktive të tjera	20	(159,260)
Aktive të vlefshme për shitje	21	-
Provizione dhe detyrime të tjera	27,28	479,130
Detyrime tatimore të shtyra	26	78,927
Interesa të arkëtuara		2,616,759
Interesa të paguara		(530,500)
Fluksi monetar neto nga aktivitetet operative		1,999,570
Fluksi monetar nga veprimtarite investuese:		
Investime në pjesëmarrje dhe filial	22	(20,125)
Blerja e aktiveve afatgjata material	18	(274,197)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	19	(22,508)
Ndryshimi neto e letrave me vlerë të vendosjes	15	(1,185,544)
Ndryshimi neto e letrave me vlerë të investimit	15	(2,191,757)
Fluksi monetar neto nga aktivitetet investuese		(3,694,131)
Fluksi monetar nga aktivitetet financuese		
Shlyerja e borxhit të varur	25	-
Fluksi monetar neto nga aktivitetet financuese		-
(Zvogëlimi)/ rritja në mjete monetare dhe ekuivalentet të tyre		(1,694,562)
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to më 1 janar		6,778,201
Mjetet monetare nga ish-NBG në datën e blerjes		7,647,074
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to më 31 dhjetor		12,730,713
		6,778,201

Shënimet shpjeguese bashkëngjitur nga 1 deri në 41 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. SUBJEKTI RAPORTUES

Banka Amerikane e Investimeve sh.a. ("Banka" e njohur më parë si Banka Credit Agricole Shqipëri sh.a.), është një filial i zotëruar tërësisht nga Tranzit sh.p.k. (i zotëruar nga fonde investimi të menaxhuara nga NCH Capital Inc), një institucion financiar jo-bankar shqiptar i cili ofron mundësi financimi për shoqëritë dhe individët.

Banka u krijua fillimisht si një degë e Bankës Tregtare të Greqisë (më pas e quajtur Banka Emporiki e Greqisë S.A.) në tetor 1998. Në tetor 1999, Banka, duke e quajtur fillimisht Intercommercial Bank - Albania sh.a., ishte e autorizuar për të vepruar në të gjitha fushat e aktivitetit bankar. Gjatë vitit 2001 Banka ndryshoi emrin e saj në Bankën Tregtare të Greqisë (Albania) sh.a. Më 1 mars 2004, emri i Bankës u ndryshua në Emporiki Bank Albania Sh.A.

Në qershor të vitit 2012, Banka Emporiki e Greqisë S.A. i shiti IUB Holding 100% të pjesëmarrjes së saj në filialin e zotëruar 100% të Emporiki Bank Albania sh.a. IUB Holding është një shoqëri anonime Franceze "par actions simplifiées", 100% filial i drejtpërdrejtë i Credit Agricole S.A. Në 3 shtator të vitit 2012 emri i Bankës ndryshoi në Banka Credit Agricole Shqipëri sh.a.. Në tetor të vitit 2015, IUB Holding shiti 100% të pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të filialit të saj, Banka Credit Agricole Shqipëri sh.a., tek Tranzit sh.p.k.. Miratimet e Rregullatorit, duke përfshirë dhe ndryshimin e emrit në Banka Amerikane e Investimeve sh.a., u finalizuan me efekt ligjor në datën 12 tetor 2015.

Më 2 shkurt 2018, Banka nënshkroi marrëveshjen për blerjen 100% të aksioneve të Banka NBG Albania sh.a.. Procesi i blerjes u finalizua më 3 korrik 2018, në vijim të aprovimit paraprak të Bankës së Shqipërisë më 6 qershor 2018. Në vijim të vendimi të Bordit të Aksionareve, në 6 shtator 2018, Banka e Shqipërisë aprovoi paraprakisht bashkimin ligjor të dy entiteteve Banka Amerikane e Investimeve sh.a. dhe Banka NBG Albania sh.a., duke përcaktuar si entitet mbijetues Bankën Amerikane të Investimeve sh.a. Bashkimi ligjor i dy entiteteve u finalizua më 1 tetor 2018.

Banka operon në përputhje me Ligjin Nr. 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" të datës 18 dhjetor 2006. Banka është e licencuar për të kryer aktivitetet e kreditimit dhe depozitimit, shërbimet e pagesave në Shqipëri dhe jashtë saj si dhe aktivitetet e tjera bankare në përputhje me ligjet Shqiptare.

Në 31 dhjetor 2018, kapitali i regjistruar aksionar ishte 3,085,459 mijë Lekë i përbërë nga 12,998 mijë Euro dhe 1,308,190 mijë Lekë (31 dhjetor 2017: 7,983,629 mijë Lekë i përbërë nga 9,998 mijë Euro dhe 6,584,519 mijë Lekë) të ndarë në 74,617 aksione të përbërë nga 30,644 aksione me vlerë nominale prej 42,690 Lekë dhe 43,973 aksione me vlerë nominale prej 295.59 Euro (31 dhjetor 2017: 70,923 aksione të përbërë nga 58,611 aksione me vlerë nominale prej 112,342.71 Lekë dhe 12,312 aksione me vlerë nominale prej 812.08 Euro).

Zyra Qëndrore e Bankës është e vendosur në Tiranë në Rrugën e Kavajës, Godina 27 kati 8 hyrja 1. Banka operon vetëm në Shqipëri me një rrjet prej 33 degësh dhe një agjenci më 31 dhjetor 2018 (31 dhjetor 2017: 19 degë).

Banka ka 469 të punësuar më 31 dhjetor 2018 (31 dhjetor 2017: 248), nga të cilët 269 (31 dhjetor 2017: 143) janë të punësuar në Zyrën Qëndrore.

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata për përputhshmërinë rregullative

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të vecanta të Bankës janë përgatitur mbi bazën e kostos historike me përjashtim të instrumenteve të borxhit me vlerë të drejtë përmes OCI, të cilat maten me vlerë të drejtë, aktiveve të vlefshme për shitje, të cilat maten me vlerën e drejtë minus koston për t'i shitur, dhe inventarit, i cili matet me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

(c) Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Këto pasqyra financiare të vecanta të Bankës janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Bankës. Gjithë informacioni i paraqitur në Lek është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur është shprehur ndryshe.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHËNIMET SHOQËRUESE

Në keto pasqyra financiare të veçanta Banka ka aplikuar SNRF9, SNRF 15 dhe SNRF 7R, që fillojnë aplikimin e parë për periudhat vjetore që fillojnë në dhe pas datës 1 janar 2018. Banka nuk ka filluar aplikimin përpara datave efektive të ndonjë standarti, interpretimi apo rishikimi tjetër të dalë por ende të pa hyrë në fuqi.

3.1 SNRF 9 Instrumentet financiare

SNRF 9 zëvendeson SNK 39 për periudhat vjetore që fillojnë në dhe pas 1 janar 2018.

Banka nuk ka rishprehur informacionin krahasues për 2017 për instrumentat financiarë që janë pjesë e SNRF 9. Prandaj informacioni krahasues për 2017 është raportuar sipas SNK 39 dhe nuk është i krahasueshëm me informacionin e paraqitur për 2018. Diferencat e dala nga aplikimi i SNRF 9 janë njohur direkt në fitimin e akumuluar në datë 1 janar 2018 dhe janë paraqitur në Shenimin 6.

3.1.1 Ndryshimet në klasifikime dhe matje

Sipas SNRF 9, percaktimi i klasifikimit dhe matjes i të gjitha aktiveve financiare përveç instrumenteve të kapitalit dhe derivativeve, duhet bërë bazuar në një kombinim të modelit të biznesit që Banka përdor për të menaxhuar aktivet dhe karakteristikat e flukseve të arkëtimeve të pritshme për instrumentet financiare.

Përpara 1 janarit 2018, Banka i ka klasifikuar aktivet financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Kredi dhe të arkëtueshme;
- Të mbajtura deri në maturim; ose
- Të vlefshme për shitje.

Nga 1 janari 2018, Banka i klasifikon aktivet financiare bazuar në modelin e biznesit për të menaxhuar aktivet dhe kushtet kontraktuale të aktiveve, të matura me:

- Koston e amortizuar;
- me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ); ose
- me vlerë të drejtë në fitim humbje (VDFH).

Detyrimet Financiare

Banka i klasifikon detyrimet financiare, duke përfshirë garancitë financiare dhe angazhimet e huave, të matura me koston e amortizuar. Referojuni politikës kontabël 3.g.

Kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë me atë të SNK 39, përveç trajtimit të fitimeve ose humbjeve që lindin nga rreziku i kredisë të një njesie ekonomike që lidhet me detyrimet e përcaktuara në VDFH, të cilat duhet të paraqiten përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse pa riklasifikim të mëvonshëm në fitim ose humbje.

3.1.1.1 Ndryshimet në metodën e përllogaritjes së zhvlerësimit

Miratimi i SNRF 9 ka ndryshuar rrënjësisht kontabilitetin e Bankës për zhvlerësimin e humbjeve nga kreditë duke zëvendësuar metodën e humbjeve të ndodhura me SNK 39 me një qasje të humbjes së mundshme të pritshme të kredisë ("HKP"). SNRF 9 kërkon që Banka të regjistrojë një fond zhvlerësimi për HKP-të për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në VDFH, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancive financiare.

Fondi i zhvlerësimit bazohet në humbjet e pritshme që lidhen me probabilitetin e dështimit në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm nëse nuk ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga krijimi i saj. Nëse aktivi financiar plotëson përkufizimin e kredisë së blerë ose të origjinar të zhvlerësuar ("POCI"), fondi i zhvlerësimit bazohet në ndryshimin e HKP-ve gjatë jetës së aktivit.

Detajet e metodës së zhvlerësimit të Bankës janë shpalosur në Shenimin 3.j. Ndikimi sasior i zbatimit të SNRF-ve me 1 janar 2018 është dhënë në Shenimin 6 Shënime të Tranzicionit.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHËNIMET SHOQËRUESE (VAZHDIM)

3.1.2 SNRF 7R

Për të pasqyruar ndryshimet midis SNRF 9 dhe SNK 39, SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese është përditësuar dhe Banka e ka aplikuar atë së bashku me SNRF 9 për vitin që fillon më 1 janar 2018. Ndryshimet përfshijnë:

- shpjegimet e tranzicionit siç tregohet në Shenimin 6
- informacion të hollësishëm cilësor dhe sasior për llogaritjet HKP siç janë supozimet dhe inputet e përdorura të paraqitur në Shënimin 9.

Rakordimi nga fondet e HKP-ve hapëse te ato mbyllëse janë paraqitur në Shënimin 16.

3.1.3 SNRF 15 Te ardhurat nga kontratat me klientet

Miratimi i SNRF 15 nuk ndikoi në kohën ose shumën e tarifave, komisioneve dhe të ardhurave të tjera nga kontratat me klientët dhe aktivet dhe detyrimet përkatëse të njohura nga Banka. Prandaj, ndikimi në informacionin krahasues është i kufizuar në kërkesat e reja të shënimeve shoqëruese. Nëse Banka do të kishte përgatitur pasqyrat financiare për vitin 2018 sipas standardit të mëparshëm të të ardhurave, SNK 18, shifrat në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018 do të kishin qene të njejta sikurse të ishin përgatitur sipas SNRF 15. Politika kontabël mbi të ardhurat përveç të ardhurave nga interesi është pasqyruar në Shënimin 4.d.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

Banka ka aplikuar në menyrë konsistente politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare, me përjashtim të standardit të ri *SNRF 9 Instrumentet Financiare*, dhe *SNRF 15 Te ardhura nga kontratat me klientët*, të cilët u aplikuan duke filluar nga 1 janari 2018 duke përdorur metodën e qasjes retrospektive të modifikuar sipas së cilës janë ndryshuar balancat e hapjes së 1 janar 2018.

a) Filiali dhe konsolidimi

Filialet janë entitete të kontrolluara nga Banka. Banka përgatit pasqyrat financiare të veçanta dhe të konsoliduara në përputhje me SNRF-të. Filialet mbahen me kosto në pasqyrat financiare të veçanta. Banka nuk përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara, pasi Mëma, Tranzit shpk përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të.

b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në atë datë. Fitim ose humbja nga kursi i këmbimit mbi zërat monetare është diferenca midis koston së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe koston së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetarë të matura me vlere te drejte në monedhë të huaj, këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Zerat jo-monetarë në monedhë të huaj të matura me kosto historike këmbehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që vijnë nga kurset e këmbimit njihen përgjithësisht në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura për këmbimin e balancave në monedhë të huaj për vitin 2018 dhe 2017 janë si më poshtë (në Lek):

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
1 USD	107.82	111.10
1 EUR	123.42	132.95
1 GBP	137.42	149.95

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

c) Interesat

Sipas SNRF 9 dhe SNK 39, të ardhurat nga interesat regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit ("NEI") për të gjithë instrumentet financiare të matur me koston e amortizuar, instrumentet financiare të dizenuar më Vlerë të Drejtë në fitim humbje ("VDFH"). Të ardhurat nga interesi për instrumentet financiare që sipas SNRF 9 maten me Vlerë të Drejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ"), të ngjashme me aktivet financiare që mbartin interes dhe që sipas SNK 39 klasifikohen si të vlefshme për shitje ose mbajtur deri në maturim, gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma, me të cilën skontohen ekzakhtësisht pagesat e vleruara të ardhshme të mjeteve monetare ose arkëtimet përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, ose kur është e përshtatshme, për periudhën më të shkurter, duke arritur në vlerën kontabel neto të aktivitetit financiar.

NEI (dhe për këtë dhe kosto e amortizuar e një aktivi) përllogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim apo prim në blerje, komisionet dhe kosto të tjera që janë pjesë integrale e NEI-t. Banka njeh të ardhurat nga interesat duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një normë konstante kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Për këtë njeh efektin e normave të ndryshme të interesit të aplikuar në faza të ndryshme, dhe karakteristika të tjera të ciklit të jetës së produktit (duke përfshirë parapagimet, gjobat dhe komisionet).

Nëse pritshmëritë në lidhje me flukset e parase për aktivin financiar rishikohen për arsye të tjera përveç rrezikut të kredisë, rregullimi regjistrohet si një rregullim pozitiv apo negativ në vlerën e mbartur të aktivitetit në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar kundrejt një rritje apo ulje të të ardhurave nga interesi. Rregullimi në vazhdim amortizohet në të ardhura nga operacionet bankare në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Interesat dhe të ardhura të ngjashme

Politika nga 1 janari 2018 (SNRF 9): Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar NEI mbi vlerën bruto të aktivitetit financiar, që nuk janë aktive të zhvlerësuar. Kur një aktiv financiar zhvlerësohet dhe për këtë arsye quhet si "Faza 3", Banka i përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar normën efektive të interesit mbi vlerën neto të aktivitetit financiar. Nëse aktivi financiar përmiresohet dhe nuk është më i zhvlerësuar, Banka e ndryshon llogaritjen e të ardhurave nga interesi mbi vlerat bruto të tij.

Për aktivet financiare të blera apo të krijuara të zhvlerësuar ("POCI") (siç shpjegohet në shënimin 4.j), Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke përllogaritur NEI-in të rregulluar dhe më pas duke e aplikuar atë normë mbi koston e amortizuar të aktivitetit.

NEI i rregulluar është norma e interesit, e cila në njohjen fillestare, skonton flukset e ardhshme të parashikuara (duke përfshirë dhe humbjen kreditore) në vlerën e amortizuar të aktivitetit POCI.

Politika para 1 janar 2018 (SNK 39): Edhe kur vlera e regjistruar e një aktivi financiar apo një grup aktivesh financiare të ngjashme është pakësuar për shkak të zhvlerësimit, e ardhura nga interesat vazhdon të përllogaritet mbi vlerën bruto të aktivitetit duke përdorur normën e interesit të njëjtë me atë të përdorur për të skontuar flukset e arkëtimeve të pritshme për qëllimin e matjes së humbjes nga zhvlerësimi.

d) Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet

Banka fiton të ardhura nga komisionet nga një shumëllojshmëri shërbimesh të cilat ia ofron klientëve të saj. Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione që janë pjesë e normës efektive të interesit të një aktivi apo detyrimi financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Të ardhurat nga komisionet mund të ndahen në tre kategoritë e mëposhtme:

- *Të ardhurat nga komisionet të fituara nga shërbimet që sigurohen gjatë një periudhe të caktuar kohe*
Komisionet e fituara për ofrimin e shërbimeve gjatë një kohe të caktuar njihen gjatë kesaj kohe. Këto komisione përfshijnë komisione për mirëmbajtje llogarie, kartë dhe shërbim E-banking.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

d) Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet

- *Të ardhura nga komisionet të fituara nga shërbimet financiare dhe nga ekzekutimi i transaksioneve*
Ketu përfshihen komisione të fituara nga urdhërat e pagesave apo transfertave të klientëve dhe shërbimeve të tjera bankare të ofruara klientëve. Këto komisione apo komponentë të tyre që
- *Nga aktiviteti huadhënës*
Komisionet e përfshira këtu ndër të tjera përfshijnë komisionet e aplikuara nga Banka për të shërbyer një kredi, një letër kredi ose një garanci bankare.

Shpenzimet e tjera për komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzime në momentin e marrjes së shërbimit.

e) Shpenzime për tatimet

Shpenzimet për tatimet përbëhen nga tatimi aktual dhe ai i shtyrë, që njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes së periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është shuma e pagueshme ose e arkëtueshme për të ardhurat e tatueshme ose për shpenzimet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim për tatimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual e pagueshme ose e arkëtueshme është vlerësuesi më i mirë i shpenzimit të pritshëm taksativ për t'u paguar ose arkëtuar që reflekton pasiguri lidhur me tatim fitimin, nëse ka. Ajo matet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të miratuar parimisht në datën e raportimit.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as në kontabilitet as në fitimin ose humbjen e tatueshme.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen mbi humbjet tatimore të mbartura, të drejtat tatimore të mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme duke konsideruar fitime të ardhshme të tatueshme, kundrejt të cilave të mund të përdoren. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo date raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është i mundur realizimi i përfitimit tatimor respektiv; reduktimet e tilla sistemohen, kur probabiliteti i fitimit të tatueshëm në të ardhmen përmirësohet.

Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo date raportimi dhe njihen deri në masën e fitimit të ardhshëm të tatueshëm që do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato mund të përdoren.

Tatimi i shtyre llogaritet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme në momentin e rimarrjes, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

f) Instrumentet financiare – njohja fillestare

I. Data e njohjes

Banka njej fillimisht huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve, depozitat, letrat me vlerë të emetuara dhe detyrimet e varura në datën në të cilën janë origjinuar. Blerjet e zakonshme dhe shitja e aktiveve financiare njihen në datën e tregëtimit në të cilën Banka angazhohet për të blere apo shitur aktivin. Të gjithë aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregëtimit në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Kreditë dhe paradhëniet dhënë klientëve njihen kur fondet janë transferuar në llogaritë e klientëve. Banka njej detyrimet ndaj klientëve kur fondet janë transferuar ne Bankë.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

f) Instrumentet financiare – njohja fillestare (vazhdim)

II. Njohja fillestare e instrumenteve financiare

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga termat e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për të menaxhuar këto instrumente. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, me përjashtim të rasteve të aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruar si aktive që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("VDFH"), për cilat kostot e transaksionit shtohen apo zbriten nga kjo vlerë.

Llogaritë e arkëtueshme maten me cmimin e transaksionit. Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare ndryshon nga cmimi i transaksionit, Banka regjistron fitimin ose humbjen e Ditës së parë, sic përkruhet me poshtë.

III. Fitimi ose humbja e Ditës së parë

Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti ndryshon nga vlera e drejtë në njohjen fillestare dhe vlera e drejtë bazohet në teknika vlerësimi që përdorin vetëm inputet e vëzhgueshme në transaksionet e tregut, Banka njihë diferencën midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto të tregimit. Në ato raste kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga inputet nuk janë të vëzhgueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë shtyhet në kohë dhe njihet vetëm në fitim ose humbje kur inputet bëhen të vëzhgueshme ose kur instrumenti çregjistrohet.

IV. Matja e kategorive të aktiveve dhe detyrimeve financiare

Duke filluar nga 1 janar 2018, Banka klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare në bazë të modelit të biznesit për menaxhimin e aktiveve dhe si dhe kushteve kontraktuale të aktiveve të matura me:

- koston e amortizuar
- VDATGJ

Përpara 1 janarit 2018, Banka i klasifikonte të gjitha aktivet financiare si hua dhe paradhëniet (kosto të amortizuar), të vlefshme për shitje ose të investimit (kosto të amortizuar).

Detyrimet financiare, përveç angazhimeve të huave dhe garancive financiare, maten me kosto të amortizuar ose me VDFH kur mbahen për tregtim ose përcaktimi i vlerës së drejtë është i aplikueshëm. Shpjeguar në politikën kontabël 4.g.

g) Aktive dhe detyrime financiare

Përpara 1 janarit 2018, hua dhe paradhënie për bankat dhe klientët përfshinin aktivet financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk ishin kuotuar në një treg aktiv, përveç atyre:

- që Banka kishte për qëllim të shiste menjëherë ose në një periudhë të afërt
- që Banka, në njohjen fillestare, të përcaktuar si VDFH ose si të vlefshme për shitje
- për të cilat Banka mund të mos marrë në mënyrë të konsiderueshme të gjithë investimin fillestar, përveç atyre me shkak përkeqësimit e kreditit, të cilat ishin përcaktuar si të vlefshme për shitje.

Huatë dhe paradhëniet për bankat, huatë dhe paradhëniet për klientët dhe investimet financiare me kosto të amortizuar

Duke filluar nga 1 janar 2018, Banka vlerëson huatë dhe paradhëniet për bankat, klientët dhe investime të tjera financiare vetëm me kosto të amortizuar nëqoftëse të dy kushtet e mëposhtme plotësohen:

- Aktivet financiare mbahen me një model biznesi me qëllimin për të mbledhur flukse monetare kontraktuale.
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin në datat e specifikuar flukse monetare të cilat përbëhen vetëm nga pagesa e principalit dhe interesat për shumën e papaguar të tij.

Detajet e këtyre kushteve përkruhen më poshtë.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

g) Instrumentet financiare – njohja fillestare (vazhdim)

Përcaktimi i modelit të biznesit

Banka përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që reflekton më mirë mënyrën se si menaxhon grupet e aktiveve financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit. Modeli i biznesit i Bankes nuk vlerësohet bazuar në instrumente individuale, por në portofole të grupuara. Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenarët në "rastin e stresit".

Nëse flukset e mjeteve monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritshmëritë fillestare të Bankes, Banka nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin informacion të tillë gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të sapo origjinuara ose ato të blera në vazhdim.

Testi SPPI

Si një hap i dytë i procesit të klasifikimit, Banka vlerëson kushtet kontraktuale të aktiveve financiare për të identifikuar nëse ata përbushin testin SPPI.

"Principali" për qëllim të këtij testi përcaktohet si vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare dhe mund të ndryshojë gjatë jetës së aktivitetit financiar (për shembull, nëse ka shlyerje të principalit ose amortizimin e primit / skontos).

Elementët më të rëndësishëm të interesit në kuadër të marrëveshjes së huadhënies janë zakonisht konsiderata për vlerën kohore të parasë dhe rrezikut të kredisë. Për të bërë vlerësimin SPPI, Banka zbaton gjykimin dhe shqyrton faktorët relevante si monedha në të cilën është shprehur aktivi financiar dhe periudha për të cilën është përcaktuar norma e interesit.

Në të kundërt, kushtet kontraktuale që paraqesin një ekspozim më pak se minimumi ndaj rreziqeve ose paqendrueshmëri në flukset monetare kontraktuale që nuk kanë lidhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, nuk krijojnë flukse kontraktuale të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit mbi tepricën e huasë. Në raste të tilla, aktivi financiar duhet të matet në VDFH.

Instrumentet e borxhit me VDATGJ (politika e aplikueshme nga 1 janari 2018)

Nga 1 janari 2018, Banka i vlerëson investimet e tjera financiare me VDATGJ nëse të dy kushtet e mëposhtme përbushen:

- Instrumenti i mbajtur brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet duke mbledhur flukset monetare kontraktuale dhe nga shitja e aktiveve financiare
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar përbushin testin SPPI

Këto instrumente kryesisht përmbajnë aktive që më parë ishin klasifikuar si investime financiare të vendosjes sipas SNK 39.

Instrumentet e borxhit me VDATGJ janë matur më pas me vlerën e drejtë në fitimet dhe humbjet që vijnë si rezultat i ndryshimit të vlerës së drejtë të njohur në ATGJ. Të ardhurat nga interesi dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimi i huaj njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Llogaritja HKP për instrumentet e borxhit shpjegohet në shënimin 4.j. Kur Banka mban më shumë se një investim në të njëjtën siguri, ato konsiderohen të disponueshme në bazën hyrje e parë dalje e parë. Nga çregjistrimi, fitimet ose humbjet kumulative të njohura më parë në ATGJ janë riklasifikuar nga ATGJ në fitim ose humbje.

Instrumentet e kapitalit me VDATGJ (politika e aplikueshme nga 1 janari 2018)

Pas njohjes fillestare, Banka zgjedh herë pas here të klasifikojë në mënyrë të pakthyeshme disa nga investimet e saj të kapitalit si instrumente të kapitalit me VDATGJ, kur ato plotësojnë përkufizimin e përcaktimit të kapitalit sipas SNK 32 *Instrumentet Financiare: Prezantimi* dhe nuk mbahen për tregtim. Një klasifikim i tillë përcaktohet mbi bazën instrument pas instrumenti.

Fitimet dhe humbjet nga këto instrumente të kapitalit nuk riciklohen kurrë në fitim. Dividentët njihen në fitim ose humbje si të ardhura të tjera operative kur është vendosur e drejta e pagesës, përveçse kur Banka përfiton nga të ardhurat e tilla si rikuperimi i një pjese të koston të instrumentit, në këtë rast, fitimet e tilla regjistrohen në ATGJ. Instrumentet e kapitalit me VDATGJ nuk i nënshtrohen një vlerësimi për zhvlerësimin.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

g) Instrumentet financiare – njohja fillestare (vazhdim)

Garancitë financiare, letrat e kreditit dhe angazhimet e huave të pashfrytëzuara

Banka leshon garanci financiare, letra krediti dhe angazhimet të huave.

Garancitë financiare njihen fillimisht në pasqyrat financiare të veçanta (brënda Provizioneve) me vlerën e drejtë, duke qenë primi i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës nën secilën garanci matet më të lartën mes shumës së njohur fillimisht duke zbritur amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave, dhe - sipas SNK 39 - vlerësimi më i mirë i shpenzimeve të kërkuara për të shlyer çdo detyrim financiar që lind si rezultat i garancisë, ose - sipas SNRF 9 - një provizion HKP siç përcaktohet në Shënimin 4.j.

Primi i marrë njihet në pasqyrën e të ardhurave në Të ardhurat neto nga komisionet me metodën lineare përgjatë jetës së garancisë.

Angazhimet e huave të pashfrytëzuara janë angazhime për të cilat, gjatë kohëzgjatjes së angazhimit, Bankës i kërkohet t'i sigurojë klientit një kredi me kushte të paracaktuara. Në ngjashmeri me kontratat e garancive financiare, sipas SNK 39, një provizion krijohet nëse ato ishin kontrata me kosto të lartë krahasuar me përfitimet, por nga 1 janari 2018, këto kontrata përfshihen në fushën e kërkesave të HKP-së.

Vlerat nominale kontraktuale të garancive financiare, letrave të kreditit dhe angazhimeve të huave të pashfrytëzuara, ku kredia për të cilën është rënë dakord është me kushtet e tregut, nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar.

Vlerat nominale të këtyre instrumenteve bashkë me HKP-të përkatëse janë paraqitur në Shënimin 16.

Letra me vlerë të investimit (politika e aplikueshme nga 1 janari 2018)

Letrat me vlerë të investimit janë aktive jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fikse, që Banka ka qëllim pozitiv dhe mundësi t'i mbajë deri në maturim dhe që nuk klasifikohen si të vlefshme për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim mbahen me kosto të amortizuara nëpërmjet metodës së interesit efektiv.

Cdo shitje ose riklasifikim i një shumë të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo afër maturitetit të tyre, do të rezultonte në riklasifikimin e gjithë investimeve të mbajtura deri në maturim si të vlefshme për shitje, dhe do ta ndalonte Bankën t'i klasifikojë ato si investime në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim për vitin ushtrimor aktual dhe dy vitet e ardhshme financiare.

Letra me vlerë të vendosjes (politika e aplikueshme nga 1 janari 2018)

Letrat me vlerë të vendosjes janë instrumente jo-derivative që nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Letrat me vlerë të pakutuara të kapitalit, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme mbahen me kosto. Të gjitha investimet e tjera të vlefshme për shitje mbahen me vlerën e drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit në letra me vlerë të borxhit të vlefshme për shitje njihen në fitim ose humbje. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen drejtpërdrejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri kur investimi të jetë shitur ose zhvlerësuar dhe fitimi ose humbja e akumuluar e njohur më parë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, riklasifikohet në fitim ose humbje.

Investimet e vlefshme për shitje mund të riklasifikohen nga kategoria të vlefshme për shitje në të mbajtura deri në maturim nëse plotësojnë perkufimizim si të mbajtura deri në maturim dhe nëse banka ka për synim dhe aftësinë për të mbajtur aktivin financiar për një të ardhme të parashikueshme, ose deri në maturim.

h) Riklasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Nga 1 janari 2018, Banka nuk i riklasifikon aktivet financiare pas njohjes fillestare përveçse në rrethana të jashtëzakonshme në të cilat Banka blen, heq nga përdorimi ose përfundon një linjë biznesi. Detyrimet financiare nuk riklasifikohen asnjëherë. Banka nuk ka riklasifikuar asnjë nga aktivet apo detyrimet financiare të saj në 2017.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

i) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Politika kontabël e aplikueshme nga 1 janari 2018

Çregjistrime nga modifikimet thelbësore të termave dhe kushteve

Banka çregjistron një aktiv financiar, të tilla si huaja për një klient, kur termat dhe kushtet janë rinegociuar në atë masë që, në thelb, bëhet një hua e re, me diferencën e njohur si fitim ose humbje nga çregjistrimi, deri në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende. Huatë e reja të njohura klasifikohen si Faza 1 për qëllimet e matjes së HKP-ve, përveçse kur kredia e re, konsiderohet të jetë POCI. Gjatë vlerësimit nëse do të çregjistrohet një hua për një klient, ndër të tjera, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi në monedhën e huasë
- Futja e një tipari të instrumentit të kapitalit
- Ndryshimi në kundërparti
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti nuk do të përmbushë më kriterin e SPPI

Nëse modifikimi nuk rezulton në flukse të mjeteve monetare që janë në thelb të ndryshme, modifikimi nuk rezulton në çregjistrim. Bazuar në ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të skontuara me NEI fillestar, Banka regjistron një fitim ose humbje modifikimi, në masën e paregjistruar të humbjes nga zhvlerësimi.

Për detyrimet financiare, Banka konsideron një modifikim si të konsiderueshëm bazuar në faktorët kualitative dhe nëse rezulton në një diferencë ndërmjet vlerës aktuale të skontuar të rregulluar dhe vlerës kontabël të detyrimit financiar prej dhjetë për qind ose më shumë. Për aktivet financiare, vlerësimi bazohet në faktorë cilesorë.

Çregjistrime të tjera përveçse ato nga modifikimet thelbësore

Aktivët financiarë

Një aktiv financiar (ose, kur është e mundur, një pjesë e një aktivi financiar ose pjesë e një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar kanë skaduar. Banka, gjithashtu çregjistron aktivin financiar nëse ka transferuar aktivin financiar si dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim.

Banka ka transferuar aktivin financiar nëse dhe vetëm nëse:

- Banka ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar; ose
- Ajo ruan të drejtat për flukset e mjeteve monetare, por ka marrë detyrimin për të paguar plotësisht flukset monetare të marra pa vonesa materiale për një palë të tretë nën një marrëveshje 'kalimtare'.

Marrëveshjet kalimtare janë transaksione ku Banka ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi origjinal"), por merr një detyrim kontraktual për të paguar këto flukse monetare në një ose më shumë njësi ekonomike ("përfituesit eventuale"), kur të treja kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Banka nuk ka asnjë detyrim të paguarjës shumë për përfituesit eventuale, përveç nëse ka arkëtuar shuma ekuivalente nga aktivi origjinal, duke përjashtuar paradheniët afatshkurtra me të drejtën për rimarrjen e plotë të shumës së huasë plus interesin e përlogarit me normat e tregut.
- Banka nuk mund të shesë ose të vendosë si kolateral aktivin fillestar përveçse si siguri për marrësit eventuale.
- Banka duhet të dorezojë çdo fluks parash që mbledh në emër të përfituesve eventuale pa vonesë materiale. Gjithashtu, Banka nuk ka të drejtë të ri-investojë flukse të tilla të parasë, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalente të parasë duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës midis datës së arkëtimit dhe datës së dergesës së kërkuar për përfituesit eventuale.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

i) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Politika kontabël e aplikueshme nga 1 janari 2018 (vazhdim)

Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Banka ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit; ose
- Banka nuk ka transferuar as ruajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit.

Banka e konsideron kontrollin të transferuar nëse dhe vetëm nëse transferuesi ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësinë e tij për një palë të tretë të palidhur dhe është në gjëndje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin.

Nëse Banka as nuk ka transferuar e as nuk mbajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet dhe ka mbajtur kontrollin e aktivit, aktivi vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Bankës, rast në të cilin, Banka njih edhe një detyrim lidhur me të. Aktivet e transferuara dhe detyrimi i lidhur me të maten në një bazë që reflekton të drejtat dhe detyrimet që Banka ka mbajtur.

Përfshirja e vazhdueshme që merr formën e një garancie mbi aktivin e transferuar matet me vlerën me të ulët midis vlerës kontabël fillestare të aktivit dhe shumën maksimale të konsideratës që Bankës mund t'i kërkohej të paguajë.

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shkruar ose të blere (ose të dyja) në aktivin e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet me vlerën që Bankës t'i kërkohej të paguajë gjatë riblerjes. Në rastin e një kontrate me opsion të shkruar mbi një aktiv që matet me vlerë të drejtë, masa e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike është e limituar më të vogël e vlerës së drejtë dhe cmimit të ushtrimit të opsionit.

Detyrime financiare

Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimi i lindur prej tij zbatohet, anulohet ose skadon.

Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet me një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë thelbësore, zëvendësimi ose modifikimi i tillë trajtohet si një çregjistrim i detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

Politika kontabël përpara 1 janarit 2018

Aktivët financiarë

Banka çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse mjeteve monetare kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar. Çdo interes që është krijuar ose mbahet nga Banka mbi aktivet financiare të transferuara që kualifikohen për çregjistrim, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Banka hyn në transaksione ku ajo transferon aktive të njohura në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar, por ruan ose të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha apo thuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshijne, për shembull, dhënie e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjes. Në transaksionet në të cilat Banka as nuk ruan e as nuk transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, e çregjistron aktivin nëse nuk do mbajë kontrollin mbi të.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

i) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Politika kontabël e aplikueshme nga 1 janari 2018 (vazhdim)

Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura gjatë transferimit njihen veçmas si aktive dhe detyrime sipas rastit. Në transferimet në të cilët mbahet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin në masën e përfshirjes së vazhdueshme, të përcaktuar nga masa në të cilën është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

Në transaksione të caktuara, Banka mban detyrimin për të shërbyer aktivin financiar të transferuar për një tarifë. Aktivi i transferuar çregjistrohet në tërësinë e tij nëse plotëson kriteret e çregjistrimit. Një aktiv ose detyrim njihet për kontratën e shërbimit, në varësi të faktit nëse tarifa e shërbimit është më shumë se e përshtatshme (aktiv) ose është më pak e përshtatshme (detyrim) për kryerjen e shërbimit. Banka shlyen kredi të caktuara kur ato janë përcaktuar të pambledhshme (shiko shënimin 6.a)

Detyrime financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë pëmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

j) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (Politika e aplikueshme nga 1 janari 2018)

Vështrim i përgjithshëm i parimeve të HKP

Sic pershkruhet ne Shenimin e (i), adoptimi i SNRF 9 ka ndryshuar rrënjësisht metodën e zhvlerësimit të humbjes së kredisë së Bankës duke zëvendësuar metodën e humbjeve të ndodhura sipas SNK 39 me atë të humbjes kreditore të pritshme. Nga 1 janari 2018, Banka ka regjistruar një fond zhvlerësimi për humbjet e pritshme të kredisë për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në VDFH, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, në këtë pjesë të gjitha të quajtura si 'instrumente financiare'. Instrumentet e kapitalit nuk janë subjekt i zhvlerësimit sipas SNRF 9.

Fondi i zhvlerësimit HKP bazohet në humbjet e kredisë që pritet të lindin gjatë jetës së aktivit (humbja e pritshme e kredisë për jetë ose AGJHKP), përveç nëse nuk ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, rast në të cilin, fondi bazohet në humbjen e pritit të kredisë në 12 muaj (12mHKP). Politikat e Bankës për të përcaktuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë janë paraqitur në Shënimin 9.

HKP 12-mujore është pjesa e AGJHKPs që përfaqëson HKP që rezulton nga ato ngjarje dështimi në instrumentet financiare që janë të mundshëm brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Të dy AGJHKP dhe 12mHKP janë llogaritur në baza individuale ose në bazë kolektive, në varesi të natyrës së portofolit të instrumenteve financiare.

Banka ka krijuar një politikë për të kryer një vlerësim, në fund të çdo periudhe raportuese, nëse rreziku i kredisë i nën instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke marrë parasysh ndryshimin në rrezikun e dështimit që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar.

Bazuar në procesin e mësipërm, Banka grumbullon kreditë e saj në Fazën 1, Fazën 2, Fazën 3 dhe POCl, siç përshkruhet më poshtë:

- Faza 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, Banka njih një zhvlerësim në bazë të 12mHKP. Kreditë e Fazës 1 gjithashtu përfshijnë kredi ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 2.
- Faza 2: Kur një kredi ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga krijimi, Banka regjistron një fond për AGJHKP-te. Kreditë e Fazës 2 gjithashtu përfshijnë kredi, ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 3.
- Faza 3: kreditë që konsiderohen të zhvlerësuara plotësisht. Banka regjistron një fond për AGJHKP-te.
- POCl: Aktivet e blera ose të origjinuara të zhvlerësuara ("POCl") janë aktivet financiare që janë të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Aktivet POCl regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një NEI të rregulluar. HKP-të njihen ose rimerren vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritshme të kredisë.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

j) Çregjistrimi i aktiveve financiare (politika e aplikueshme pas 1 janarit 2018) (vazhdim)

Vështrim i përgjithshëm i parimeve të HKP (vazhdim)

Për aktivet financiare për të cilat Banka nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e të gjithë shumës së mbetur, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e aktivitetit financiar zvogëlohet. Ky konsiderohet një çregjistrim (i pjesshëm) i aktivitetit financiar.

Përlllogaritja e HKP-ve

Banka llogarit HKP-të në bazë të tre skenarëve të ponderuar me probabilitet e ndodhjes për të matur mungesat e flukseve të pritshme të arkëtimeve, të skontuara në një përaftrim me NEI. Një mungesë e arkëtimeve të pritshme është diferenca midis flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të pritshme dhe atyre që njësisia ekonomike pret të arkëtojë.

Mënyra e llogaritjeve HKP është përshkruar më poshtë dhe elementët kryesorë janë si vijon:

- PD – *Mundësia e dështimit ("PD")* është një vlerësim i mundësisë së dështimit gjatë një horizonti kohor të dhënë. Një dështim mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar gjatë periudhës së vlerësimit, nëse aktivi nuk është çregjistruar më parë dhe vazhdon të qëndrojë në portofolin e Bankës.
- EAD – *Ekspozimi në Dështim ("EAD")* është një vlerësim për ekspozimin në një datë të ardhshme dështimi, duke marrë në konsideratë ndryshimet e pritshme në ekspozim pas datës së raportimit, duke përfshirë parapagimet e principalit dhe interesit, të skeduluara në kontratë apo jo, tërheqjet e pritshme në angazhime për financim të dhëna, dhe interesat nga pagesat e pakryera.
- LGD – *Dështimi në humbje ("LGD")* është një vlerësim i humbjes që del në rastin kur ndodh një dështim në një kohë të dhënë. Ai bazohet në diferencën midis flukseve kontraktuale të arkëtimeve dhe atyre që huadhenesi pret të arkëtojë.

Për llogaritjen e HKP-ve, Banka konsideron tre skenare (bazë, optimist dhe pesimist). Secila prej tyre shoqërohet me PD të ndryshme. Kur është e rëndësishme, vlerësimi i skenarëve të shumtë përfshin gjithashtu se si pritet të rikuperohen huatë e papaguara, duke përfshirë dhe mundësinë që huatë do të kurohen dhe vlera e kolateralit ose shumat mund të merret nga shitja e aktivitetit.

Periudha maksimale për të cilën përcaktohen humbjet e kredisë është jeta kontraktuale e një instrumenti financiar, përveç nëse Banka ka të drejtën ligjore ta quajë atë më herët.

Humbjet dhe lëshimet nga zhvlerësimi llogariten dhe shpalosen veçmas nga humbjet ose fitimet e modifikimit që llogariten si një rregullim i vlerës kontabël bruto të aktivitetit financiar.

Mekanika e metodës HKP është përmbledhur më poshtë:

- Faza 1: 12mHKP llogaritet si pjesë e AGJHKP-ve që përfaqësojnë HKP-të që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Banka llogarit fondin e 12mHKP bazuar në pritshmërinë e një mospagimi që ndodh në 12 muajt pas datës së raportimit. Këto probabilitete të dështimit të pritur 12-mujor aplikohen mbi një EAD të parashikuar dhe shumëzohen me LGD-në e pritshme dhe të skontuar me një NEI të përfaqësuar me origjinalin. Kjo llogaritje bëhet për secilin nga tre skenarët, siç është shpjeguar më sipër.
- Faza 2: Kur një hua ka shfaqur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi i saj, Banka regjistron një fond për AGJHKP. Mekanika është e ngjashme me ato të shpjeguara me sipër, duke përfshirë përdorimin e skenarëve të shumtë, por PD-të vlerësohen gjatë gjithë jetës së instrumentit. Mungesat e arkëtimeve të pritura të parave skontohen me një përfaqësim të NEI-t origjinal.
- Faza 3: Për kreditë që konsiderohen si të zhvlerësuar, Banka njeh humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës për këto kredi me llogaritje zhvlerësimi individual. Si parim, shumat e provizionit e kredive që zhvlerësohen në baza individuale llogaritet si diferenca ndërmjet shumës së mbetur papaguar të kredisë me a) shumën e kolateralit likuid dhe me b) shumën e vlerës aktuale të të gjitha flukseve monetare të ndryshme të zbritura me normën aktuale të interesit të kredisë

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

j) Çregjistrimi i aktiveve financiare (politika e aplikueshme pas 1 janarit 2018) (vazhdim)

Përlllogaritja e HKP-ve (vazhdim)

- Aktivet POCl janë aktive financiare që janë të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Banka njeh vetëm ndryshimet kumulative AGJHKPs që nga njohja fillestare, bazuar në skenarë me probabilitete, skontuar nga NEI i rregulluar.

Angazhimet e huave, letrat e kreditit dhe garancitë financiare:

Faktori i konvertimit të kredisë përdoret për të kthyer shumën e një linje krediti (pjesa e papërdorur) dhe shumën të tjera jashtë bilancit në një shumë të EAD. Është një supozim i modeluar, i cili përfaqëson një pjesë të çdo ekspozimi të papërdorur që pritet të tërhiqet para se të ndodhë një ngjarje e paracaktuar. Për secilin lloj produkti, faktori CCF për Bankën zbatohet si më poshtë:

- Letër garancia & letër krediti me maturitet të mbetur ≤ 1 year = 20%
- Letër garancia & letër krediti me maturitet të mbetur > 1 year = 50%
- Pjesa e papërdorur e kredive me afat = 0%
- Pjesa e papërdorur e overdrafteve = 20%
- Pjesa e papërdorur e kartave të kreditit = 20%

Instrumente të borxhit të matura me vlerën e drejtë nepërmjet ATGJ

HKP-ja për instrumente të borxhit të matura me VDATGJ nuk e zvogëlojnë vlerën kontabël të këtyre aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila mbetet me vlerën e drejtë. Përkundrazi, një shumë e njëjtë me fondin, që do të krijohet nëse aktivet që maten me koston e amortizuar, njihet në ATGJ si një shumë zhvlerësimi e akumuluar, me një ngarkimin përkatës në fitim ose humbje. Humbja e akumuluar e njohur në ATGJ do të ricklohet në fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit të aktivitetit.

Aktive financiare të blera ose të gjeneruara të zhvlerësuara (POCl)

Për aktivet financiare POCl, Banka njeh vetëm ndryshimet kumulative në AGJHKP që nga njohja fillestare në fondin e humbjeve.

Informacion për ndodhi që priten të ndodhin

Në modelet e saj HKP, Banka mbështetet në një gamë të gjërë informatash të ardhshme, si inpute ekonomike, si:

- Rritja e Produktit të Brëndshëm Bruto ("PBB")
- Normat e papunësisë
- Normat bazë të Bankës Qëndrore
- Normat e inflacionit

Inputet dhe modelet e përdorura për llogaritjen e HKP-ve nuk mund të kapin gjithnjë karakteristikat e tregut në datën e pasqyrave financiare. Për të pasqyruar këtë, rregullime cilësore bëhen herë pas here si rregullime të përkohshme kur dallimet e tilla janë dukshëm materiale.

k) Përmirësimet e kredisë: vlerësimi i kolateraleve dhe garancitë financiare

Për të zvogëluar rrezikun e kredisë mbi aktivet financiare, Banka kërkon të përdorë kolaterale, kur është e mundur. Kolaterali vjen në forma të ndryshme, të tilla si para, letra me vlerë, letra krediti / garanci, pasuri të paluajtshme, arkëtime, inventarë dhe aktive të tjera jo-financiare. Politika e kontabilitetit të Bankës për kolateralët, që i është caktuar asaj përmes marrëveshjeve të huazimit sipas SNRF 9, është e njëjtë me atë siç ishte në SNK 39. Kolaterali, përveç nëse merret në pronësi, nuk regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

k) Përmirësimet e kredisë: vlerësimi i kolateraleve dhe garancitë financiare (vazhdim)

Sidoqoftë, vlera e drejtë e kolateralit ndikon në llogaritjen e HKP-ve. Në përgjithësi vlerësohet, në minimum, në fillim dhe rivlerësohet në baza të shpeshta [periudha të ndryshme për lloje të ndryshme: Për shembull për kolaterale pasuri të paluajtshme, frekuenca është vjetore (ambjente biznesi) ose çdo 3 vjet (ambjente banimi)]. Sidoqoftë, disa kolaterale, për shembull, para ose letra me vlerë që kanë të bëjnë me kërkesat e marginalizimit, vlerësohen çdo ditë.

Me aq sa është e mundur, Banka përdor të dhëna të tregut aktiv për vlerësimin e aktiveve financiare të mbajtura si kolateral. Aktivet e tjera financiare që nuk kanë vlera të tregut të përcaktueshme lehtësisht, vlerësohen duke përdorur modele. Kolaterali jofinanciar, siç është pasuria e paluajtshme, vlerësohet bazuar në të dhënat e paraqitura nga palët e treta siç janë vlerësuesit e brendshëm / të jashtëm të pasurive.

Nëse një kredi, si pjesë e kushteve të saj kontraktuale, është e garantuar nga një palë e tretë, Banka vlerëson HKP përkatëse bazuar në rrezikun e kombinuar të kredisë së garantuesit dhe palës së garantuar, duke reflektuar garancinë në matjen e humbjes në rast dështimi (LGD). Banka e konsideron garancinë financiare si përbërëse të kushteve kontraktuale të kredisë së garantuar, kur garancia është bere në të njëjtën kohë, ose brenda një kohe të shkurtër, pas avancimit të kredisë.

Garancitë që nuk janë paresore për kushtet e kontratës së kredisë, llogariten si njësi e veçantë e llogarive që i që janë subjekt i HKP-së.

l) Inventari (aktive të marra në zotërim)

Politika kontabël e Bankës nën SNRF 9 ka mbetur e njëjta me atë nën SNK 39. Politika e Bankës përcakton nëse një aktiv i marrë në zotërim mund të përdoret për operacionet e brëndshme ose duhet shitur. Aktivet e përcaktuara si të dobishme për operacionet e brëndshme transferohen në kategorinë përkatëse të aktiveve me vlerën më të ulët midis vlerës së marrjes në pronësi ose vlerës kontabël të aktivitet origjinal. Aktivet për të cilat shitja përcaktohet të jetë një opsion më i mirë transferohen në aktivet e mbajtura për shitje me vlerën e tyre të drejtë (nëse janë aktive financiare) dhe vlerën e drejtë pakësuar me koston për të shitur për aktivet jo-financiare në datën e rimarrjes, në përputhje me politikën e Bankës

Në rrjedhën e saj normale të biznesit, Banka angazhon agjentë të jashtëm për të rikuperuar fonde nga aktivet e rivlerësuar, përgjithësisht në ankand, për të shlyer borxhin e mbetur. Cdo fond i tepërt u kthehet klientëve / debitorëve. Si rezultat i kësaj praktike, pronat e banimit në proceset e riblerjes ligjore nuk janë regjistruar në bilanc.

m) Fshirjet

Më përjashtim të fshirjeve të pjesshme, politika e kontabilitetit të Bankës sipas SNRF 9 mbetet e njëjtë me atë të SNK 39. Aktivet financiare fshihen pjesërisht ose tërësisht vetëm kur Banka nuk ka pritshmëri të arsyeshme për të recuperuar një aktiv financiar në tërësi ose një pjesë të tij. Nëse shumat që duhet të fshihen është më e madhe se fondi i zhvlerësimit të akumuluar, diferenca fillimisht trajtohet si shtesë e këtij fondi, i cili më pas aplikohet ndaj vlerës kontabël bruto. Çdo rimarrje pasuese kreditohet të shpenzimi i humbjeve të kredisë.

n) Hua të ristrukturuara dhe modifikuara

Banka ndonjëherë bën lëshime ose modifikime të kushteve origjinale të kredisë si përgjigje ndaj vështirësive financiare të huamarrësit, në vend që të marrë në pronësi ose të zbatojë ndryshe mbledhjen e kolateralit.

Banka e konsideron një kredi të ristrukturuar kur lëshime të tilla ose modifikime janë dhënë si rezultat i vështirësive financiare aktuale ose te pritura të huamarrësit dhe Banka nuk do të kishte pranuar nese huamarrësi do të ishte i shëndetshëm financiarisht. Treguesit e vështirësive financiare përfshijnë dështim në kovenantë ose shqetësimet e rëndësishme të ngritura nga Njësia e Menaxhimit të Riskut të Kredisë.

Ristrukturimi mund të përfshijë zgjerimin e marrëveshjeve të pagesës dhe marrëveshjen me kushtet e reja të kredisë. Pasi temat janë rinegociuar, çdo zhvlerësim matet duke përdorur NEI-n origjinal siç është llogaritur para modifikimit të termave. Është politikë e Bankës monitorimi i kredive të ristrukturuara për të siguruar që pagesat në të ardhmen të vazhdojnë të ndodhin.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

n) Hua të ristrukturuara dhe modifikuara (vazhdim)

Vendimet e çregjistrimit dhe klasifikimi midis Fazës 2 dhe Fazës 3 përcaktohen në bazë të kriterëve të paracaktuara. Nëse këto procedura identifikojnë një humbje në lidhje me një kredi, ajo shpaloet dhe menaxhohet si një aktiv i zhvlerësuar i Fazës 3 derisa të arkëtohet, periudha e provës të përfundojë me sukses, ose të shlyhet.

Nga 1 janari 2018, kur kredia është ristrukturuar ose modifikuar por nuk është çregjistruar, Banka rivlerëson gjithashtu nëse ka pasur rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë. Banka konsideron nëse aktivet duhet të klasifikohen si Faza 3. Sapo një aktiv të jetë klasifikuar si i ristrukturuar, ai do të mbetet i ristrukturuar për një periudhë minimale provë 12-mujore. Në mënyrë që huaja të riklasifikohet nga kategoria e ristrukturimeve, klienti duhet të plotësojë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- Të gjitha ekspozimet e tij konsiderohen si performuese
- Periudha e provës prej një viti ka kaluar që nga data që kontrata e ristrukturimit konsiderohej si performuese.
- Klienti nuk ka më kontrata që kanë më shumë se 30 ditë vonesa.

o) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (Politika kontabël përpara 1 janarit 2018)

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ka prova objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar. Aktivet financiare ose një grup i aktiveve financiare janë zhvlerësuar kur provat objektive tregojnë se një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në flukset e ardhshme të parave të aktivitetit që mund të vlerësohen me besueshmëri.

Provat objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijnë dështim në pagesë nga një huamarrës, ristrukturimin e një kredie ose paradhënie nga Banka me kushte që Banka nuk do t'i konsideronte ndryshe, indikacione që një huamarrës ose emetues do të hyjë në falimentim, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të vëzhguara, që lidhen me një grup asetesh, siç janë ndryshimet e pafavorshme në statusin e pagesës së huamarrësve ose emetuesve në grup, ose kushteve ekonomike që lidhen me mospagesat në grup.

Banka merr në konsideratë provat e zhvlerësimit të kredive dhe paradhëniesve si në një aktiv të veçantë ashtu edhe në atë kolektiv. Të gjitha kreditë e rëndësishme individuale vlerësohen për një zhvlerësim specifik. Të gjitha huatë dhe paradhëniet domethënëse individuale të konstatuara se nuk janë zhvlerësuar në mënyrë specifike, atëherë vlerësohen kolektivisht për çdo zhvlerësim që mund të ketë ndodhur por nuk është identifikuar ende. Huatë dhe paradhëniet që nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen kolektivisht për zhvlerësimin duke grupuar së bashku kreditë dhe paradhëniet me karakteristika të ngjashme rreziku.

Në vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv, Banka aplikon si minimum tendencat historike të koeficientëve të humbjes, kohën e rikuperimit dhe shumën e humbjeve të ndodhur për secilin grup homogjen të huave dhe paradhëniesve, i cili bazohet në prova objektive të zhvlerësimit. Koeficientet e humbjes dhe koha e pritshme e rikuperimeve të ardhshme krahasohen rregullisht kundër rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbartura me koston e amortizuar maten si diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit financiar dhe vlerës aktuale të fluksit të parashikuar të parasë të skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari të zhvlerësimit kundrejt huave dhe paradhëniesve ose letrave me vlerë të investimit. Kur një ngjarje e ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit shkakton uljen e shume e humbjes nga zhvlerësimi, ulja e humbjes nga zhvlerësimi kthehet në pasqyrën e fitimit humbjeve.

Humbjet nga zhvlerësimi mbi letrat me vlerë të vendosjes, nëse ka, njihen duke riklasifikuar humbjet e akumuluar në rezervën për ndryshimet në vlerën e drejtë në kapital të pasqyra e fitimit ose humbjes. Humbja e akumuluar që është riklasifikuar nga kapitali të pasqyra e fitimit ose humbjes është diferenca mes koston së blerjes, e netuar nga ripagesat e principalit dhe amortizimi, dhe vlerës së drejtë aktuale, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi të njohur më parë të pasqyra e fitimit ose humbjes.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

o) Zhvlerësimet e aktiveve financiare (Politika e aplikueshme përpara 1 janarit 2018 (vazhdim))

Ndryshimet në provizionet e zhvlerësimeve të atribueshme të aplikim i metodës së interesit efektiv janë reflektuar si një përbërës i të ardhurave nga interesi. Nëse, në një periudhë pasardhëse, vlera e drejtë e një letre me vlerë të vendosjes e zhvlerësuar rritet dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur, me pas humbja në fjalë anulohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes; përndryshe, cdo rritje në vlerën e drejtë njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Megjithatë cdo rimarrje pasuese, në vlerën e drejtë të një letre me vlerë të vendosjes të zhvlerësuar, gjithmonë njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

p) Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera e drejtë është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm në tregun kryesor (ose më të favorshëm) në datën e matjes, nën kushtet aktuale të tregut (p.sh. një cmim dalje) pavarësisht nëse ai cmim është direkte i vëzhgueshëm ose i vlerësueshëm duke përdorur metodë tjetër vlerësimi. Kur vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të llogariten nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një shumëllojshmeri teknikash vlerësimi që përfshijnë dhe përdorimin e modeleve të vlerësimit. Inputet në këto modele merren nga tregjet të vëzhgueshme ku është e mundur, por kur kjo nuk është e mundur, vlerësimi kërkohet në përcaktimin e vlerave të drejta. Gjykimet dhe vlerësimet përfshijnë konsiderime për likuiditetin dhe inpute të modeleve të lidhura me zëra si rreziku i kredisë (si i veti ashtu dhe i palëve), rregullimet e vlerës së financimit, korrelacionin dhe paqëndrueshmërinë. Për më shumë detaje rreth përcaktimit të vlerës së drejtë, ju lutemi shikoni Shënimin 7.8 dhe Shënimin 48.

q) Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjete monetare dhe të ngjashme përfshijnë para në arkë, balanca në Bankën Qëndrore të pakufizuara në përdorim dhe aktive financiare shume likuide me maturim fillestar deri në tre muaj ose më pak nga data e blerjes, të cilat kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

r) Marreveshjet e blerjes dhe të riblerjes

Letrat me vlerë të shitura nën një marrëveshje për t'u riblerë në një datë specifike në të ardhmen nuk regjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar ndërsa Banka mban në mënyre thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

Paratë përkatëse të marra njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv me detyrimin përkatës për kthimin e tyre, përfshirë interesin e përlogaritur si një detyrim brenda kolateralit të parave mbi letrat me vlerë të lena dhe marrëveshjet e riblerjes, duke pasqyruar substancën ekonomike të transaksionit si një kredi ndaj Bankës.

Diferenca midis çmimeve të shitjes dhe riblerjes trajtohet si shpenzim i interesit dhe përlogaritet gjatë gjithë jetës së marrëveshjes duke përdorur NEI. Kur kunderpala ka të drejtë të shesë ose të rivendosë letrat me vlerë, Banka i riklasifikon ato letrat me vlerë në pasqyrën e pozicionit financiar si letra me vlerë të mbajtura për tregtim të vena si kolateral ose si letra me vlerë të vendosjes të vena si kolateral, siç është e përshtatshme.

Në të kundërt, letrat me vlerë të blera të lidhura me marrëveshjen për t'u shitur në një datë të caktuar të ardhshme nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Shuma e paguar, përfshirë interesin e përlogaritur, regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar, brenda kolateralit të parave të gatshme për letrat me vlerë të huazuara dhe marrëveshjet e riblerjes të anasjellta, duke pasqyruar substancën ekonomike të transaksionit si një kredi nga Banka. Diferenca midis çmimeve të blerjes dhe rishitjes regjistrohet në të ardhurat neto nga interesi dhe është përlogaritur gjatë gjithë jetës së marrëveshjes duke përdorur NEI.

Nëse letrat me vlerë, të blera në bazë të një marrëveshjeje për t'u rishitur, i shiten më pas një pale të tretë, detyrimi për kthimin e letrave me vlerë regjistrohet si një shitje e shkurtër brenda detyrimeve financiare të mbajtura për tregtim dhe matet me vlerën e drejtë me çdo fitim ose humbje të përfshirë në të ardhurat neto nga tregtimi.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

s) Qiraja financiare

Banka si qiramarrese – Pagesat operative te qerase

Përcaktimi nëse një marrëveshje është një kontratë qiraje ose përmban një kontratë qiraje, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose pasurie të caktuar dhe marrëveshja përcjell të drejtën për të përdorur asetin. Qiratë që nuk transferojnë në Bankë në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e sendeve të dhëna me qira janë qiratë operative. Pagesat e bëra sipas qirasë operative njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në baza lineare gjatë periudhës së qirasë. Inisiativat e qerasë janë njohur si një pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

Banka si qiradhënëse

Qiratë në të cilat Banka transferon kryesisht të gjithë rrezikun dhe përfitimet nga pronësia e aktivitetit klasifikohen si qira financiare. Në pasqyrën e pozicionit financiar Banka paraqet shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën e investimit neto. Njohja e të ardhurave financiare duhet të zbatohet në një model që pasqyron një normë periodike konstante të kthimit të investimit neto të qiradhënësit në qiranë financiare. Pagesat e qirasë për periudhën, pa përfshire kostot për shërbime, aplikohen kundrejt investimit bruto në qira, për të reduktuar si principalin ashtu dhe të ardhurat e pafituara të financimit.

Të ardhurat e shitjeve të njohura në fillimin e afatit të qirasë nga një prodhues ose qiradhënësi janë vlera e drejtë e aktivitetit ose, nëse është më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të qirasë që rrjedhin nga qiradhënësi, të llogaritura me një normë tregu të interesit.

t) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat lidhen drejtëpërdrejtë me blerjen e aktivitet. Nëse pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, atëherë këto pjesë kontabilizohen si zëra të veçanta (përbërësit kryesor) të aktiveve afatgjatë materiale. Cdo fitim ose humbje nga shitja ose nxjerrja jashtë përdorimi i një aktivitet afatgjatë (të llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitja e aktivitet dhe vlerës kontabël të aktivitet) njihet te të ardhurat e tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kosto të tjera pasuese

Kostot e zëvendësimit të një pjesë të aktivitet njihen me vlerën kontabël të aktivitet nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike që lidhen me këtë aktivitet do të rrjedhin për Bankën dhe nëse kostot e tij mund të maten në mënyrë të besueshme.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të cdo pjesë të aktivitet afatgjatë material. Trualli dhe veprat e artit nuk zhvlerësohen. Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhën aktuale janë të paraqitura si më poshtë:

	<u>Në vite</u>
• Ndërtesa	40
• Mobilje dhe pajisje zyre	5
• Automjete	5
• Përmirësimet e ambjenteve të marra me qira	9-12
• Kompjuterat dhe pajisjet elektronike	4-5

Aktivitet nuk amortizohen deri në momentin që fillojnë të përdoren dhe transferohen nga aktive në ndërtim apo zhvillim, në kategorinë përkatëse të aktiveve.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

u) Aktive afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe cdo humbje nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktivit. Jeta e dobishme e vlerësuar paraqitet si më poshtë:

	<u>në vite</u>
• Programe dhe aplikacione të teknologjise informative	4-10

v) Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Vlera kontabel e aktiveve jofinanciare të Bankës, të ndryshme nga aktivët tatimore të shtyra dhe inventarët, rishikohen çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ka një tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në rast se vlera kontabel e aktivit është më e madhe se vlera e tij e rikuperueshme.

Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve i cili gjeneron flukse monetare, të cilat në masë të madhe janë të pavarura nga aktivët e tjera ose grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur fillimisht për të pakësuar vlerën kontabel të emrit të mirë të alokuar kësaj njësie gjeneruese të mjeteve monetare dhe më pas për të ulur vlerën kontabel të aktiveve të tjera të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare (grup njësisish gjeneruese të mjeteve monetare), me bazë të ponderuar.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese së mjeteve monetare është me e madhja midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë duke zbritur koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuarat monetare të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

w) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarje në të kaluarën, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv dhe ka të ngjarë të ketë një dalje të burimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme, edhe rreziqe specifike ndaj detyrimit. Shpenzimet lidhur me cdo provizion prezantohen në pasqyrën e të ardhurave neto nga cdo rimbursim në shpenzime të tjera operacionale.

x) Perfitimet e punonjesve

Banka paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqerore, të cilat përfitohen nga punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuar. Kontributet e Bankës për planin e pensionit ngarkohen në fitim ose humbje në momentin kur ato ndodhin.

y) Investime në filiale

Investimi në një pjesëmarrje është një entitet mbi të cilin Shoqëria ka ndikim pozitivisht. Ndikim i rëndësishëm është fuqia për të marrë pjesë në vendimet e politikës financiare dhe operative të të investuarit, por nuk është kontroll ose kontroll i përbashkët mbi këto politika.

Konsideratat e bëra në përcaktimin e ndikimit të rëndësishëm ose të kontrollit të përbashkët janë të ngjashme me ato të domosdoshme për të përcaktuar kontrollin mbi filialet. Investimi i Bankës në shoqërinë e tij llogaritet me kosto. Investimi kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmë të bankës, Tranzit shpk.

Pas humbjes së ndikimit të rëndësishëm mbi pjesëmarrjen, Banka mat dhe njeh cdo investim të mbartur në vlerën e tij të drejtë. Cdo diferencë midis vlerës kontabel neto të pjesëmarrjes pas humbjes së ndikimit të rëndësishëm dhe vlerës së drejtë të investimit të mbartur dhe të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit njihen në fitim ose humbje.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

5. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIME ENDE TË PAMIRATUARA

Standartet dhe interpretimet që janë lëshuar, por që nuk janë ende efektive deri në datën e nxjerrjes së pasqyrave financiare të Bankës janë dhënë më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

• SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është lëshuar në janar të vitit 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiradhënie, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marreveshje përmban një Qira, SIC-15 Qiratë Operative-Nxitjet dhe KIS-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënie të informacioneve shpjeguese të qirasë dhe kërkon që qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm në bilanc, i ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Standardi përfshin dy përjashtime të njohjes për qiramarrësit - qiratë e aktiveve "me vlerë të ulët" (p.sh., kompjuteret personale) dhe qiratë afatshkurtra (dmth. me qera me një afat kohor prej 12 muaj ose më pak). Në datën e fillimit të një qiraje, një qiramarrës do të njohë një detyrim për të bërë pagesa të qiraseë (dmth. detyrimin e qirasë) dhe një aktiv që përfaqëson të drejtën e përdorimit të aktivit bazë gjatë afatit të qirasë (dmth. aktivin me të drejtë përdorimi). Qiramarrësve do t'u kërkohe të njohin veçmas shpenzimet e interesit në detyrimet e qirasë dhe shpenzimet e amortizimit në aktivin me të drejtë përdorimi.

Qiramarrësve gjithashtu do t'u kërkohe që të rivlerësojnë detyrimin e qirasë me rastin e ngjarjeve të caktuara (p.sh. një ndryshim në afatin e qirasë, në pagesat e qirasë së ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks apo normë të përdorur për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohë shumën e rimahtës së detyrimit të qirasë si një rregullim në aktivin e së drejtës së përdorimit.

Kontabiliteti i qiradhënësit sipas SNRF 16 është në thelb i pandryshuar nga kontabilizimi i aktual sipas SNK 17. Qiradhënësit do të vazhdojnë të klasifikojnë të gjitha qiratë duke përdorur të njëjtin parim klasifikimi si në SNK 17 dhe të bëjnë dallimin midis dy llojeve të qirass: qiratë operative dhe financiare.

SNRF 16, i cili është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2019, kërkon që qiramarrësit dhe qiradhënësit të japin më shumë informacion shpjegues se sa sipas SNK 17.

Tranzicioni ne SNRF 16

Banka do të zgjedhë të aplikojë standardin të kontratat që janë identifikuar më parë si qira duke aplikuar SNK 17 dhe KIRFN 4. Si rrjedhojë Banka nuk do të aplikojë standardin të kontrata të cilat nuk janë identifikuar më parë me përmbajtje qiraje duke aplikuar SNK 17 dhe KIRFN 4.

Banka do të zgjedhë përdorimin e përjashtimeve të propozuara nga standardi në kontrata qiraje për të cilat termat e qirasë mbarojnë brenda 12 muajve nga data e aplikimit fillestar dhe kontratat e qirasë për të cilat aktiviteti themelor ka vlerë të vogël.

Që nga 1 janari 2019, Banka ka bërë vlerësim fillestar mbi impaktin e mundshëm të implementimit të SNRF 16, dhe ka vlerësuar që detyrimet dhe aktiviteti me të drejtë përdorimi do të jenë në kufirin e 450,000 – 500,000 mijë Lekë, në varësi të faktit se Banka ka ende për të sqaruar vlerësime dhe supozime të vogla.

Për standartet dhe interpretimet e reja të meposhtme, Banka parashikon që miratimi i tyre nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të vecanta të Bankës në periudhën e aplikimit fillestar dhe nuk pritet të ketë ndikim mbi pasqyrat financiare të vecanta të Bankës:

- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- **KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare" - Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019),

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

5. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIME ENDE TË PAMIRATUARA (VAZHDIM)

- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri sa metoda e kapitalit të jetë perfunduar)
- **Ndryshimet në SNK 19: Amendamenti i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja** - kontabilizimi kur një ndryshim, shkurtrim ose shlyerje plani ndodh gjatë një periudhe raportuese (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019)
- **Korniza konceptuale në standardet e SNRF** - Për përgatitësit që zhvillojnë politika kontabël bazuar në Kornizën Konceptuale (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020),
- **SNRF 3: Kombinimet e Biznesit (Amendamentet)** - ndryshimet në Përkufizimin e një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në periudhën e parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe, me aplikim të hershëm te lejueshëm),
- **SNK 1: Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i 'materialit' (Ndryshimet)** - qartëson përkufizimin e materialit dhe si duhet zbatuar (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2020 me aplikimin e mëparshëm të lejuar),
- **Ndryshime në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)"** që rrjedh nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve, i cili hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, duke përfshirë:
 - SNRF 3 Kombinimet e Biznesit dhe SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta
 - SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat
 - SNK 23 Shpenzimet e huamarrjes.

6. STANDARDET E LËSHUARA DHE NË FUQI PËR PERIU DHËN VJETORE

Standartet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht amendime të standardeve ekzistuese dhe interpretime të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël janë efektive për periudhën aktuale, por adaptimi i tyre nuk ka sjellë ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Bankës:

- **Ndryshime në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione"** – Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione (efektive duke filluar nga 1 janari 2018 e në vazhdim),
- **Ndryshime në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"** – Aplikuar në SNRF 9 "Instrumentat financiare" me SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" (efektive duke filluar nga 1 janari 2018 e në vazhdim ose kur SNRF 9 "Instrumentat financiare" të aplikohet për herë të parë),
- **Ndryshime në SNK 40 "Investime në pasuri të paluajtshme"** – Transferimet në investimet në pasuri të paluajtshme (efektive duke filluar nga 1 janari 2018 e në vazhdim),
- **KIRFN 22 "Transaksionet valutë dhe Konsiderata për avancat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28 për shkak të "Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** - Ndryshime që rezultojnë nga rishkimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 and SNK 28) kryesisht me qëllim që të shmangen mospërputhjet dhe të qartësohet formulimi i standardit (ndryshimet e SNRF 1 dhe SNK 28 aplikohen për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2018 e në vazhdim).

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozon Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- a. rreziku i kredisë
- b. rreziku i likuiditetit
- c. rreziku i tregut
- d. menaxhimi i kapitalit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj cdo rreziku të përmendur më lart, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset e Bankës për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Kuadri i administrimit të rrezikut

Bordi i Drejtuesve ka përgjegjësi për vendosjen dhe mbikqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka krijuar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Rrezikut të Kredisë dhe Çështjeve Sensitive (SAC), dhe komitetin e Provizionimit, të cilët kanë përgjegjësi për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut të Bankës në fushat e tyre specifike. Të gjithë komitetet e Bordit kanë anëtarë ekzekutivë dhe jo-ekzekutivë dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtuesve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut janë hartuar që të evidentojnë dhe të analizojnë rreziqet e hasura nga Banka, për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Politikat e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut.

Banka nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i Auditit i Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Për të kryer funksionet e veta Komiteti i Auditit mbështetet nga Auditit i Brendshëm. Auditit i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt dhe 'ad-hoc' politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Auditit.

(a) Rreziku i kredisë

Gjatë aktivitetit normal të saj, Banka ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, nga investimet në letra me vlerë dhe në zëra të tjerë jashtë bilancit. Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës në rast se huamarrësi ose pala tjetër e një instrumenti financiar nuk përmbush detyrimet kontraktuale, dhe ky rrezik buron kryesisht nga huatë dhe paradhëniet e klientëve dhe nga letrat me vlerë të borxhit dhe financimet ndaj institucioneve financiare ose zëra të tjerë jashtë bilanci. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut të kredisë (si rreziku i mospërmbushjes së detyrimit individual, rreziku sovran ose i industries). Banka menaxhon rrezikun e ekspozimit të kredisë sistematikisht duke monitoruar drejtëpërdrejtë limitet e kredive, portofolin e kredive dhe përqëndrimin e ekspozimit.

Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Bordi i Drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Kredisë së Bankës. Sektori i Rrezikut të Kredisë, që raporton paralelisht tek Drejtori Ekzekutiv, është përgjegjës për mbikqyrjen e rrezikut të kreditit të Bankës. Menaxhimi i rrezikut të kredisë realizohet përmes:

Krijimit të politikave të rrezikut të kredisë në konsultim me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësimin e kredive, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut dhe përputhshmërinë me kriteret rregullatore dhe ligjore.

Vendosjes dhe monitorimit të niveleve të delegimit dhe procesit të shkallëzimit në lidhje me miratimet e kredisë. Bordi i Drejtuesve i ka deleguar Komitetit të Kredisë autoritetin për miratimin e shumave deri në ekuivalentin e 3,000,000 EURO për rritjen e limiteve ekzistuese të kredive apo dhënien e kredive të reja, dhe deri në ekuivalentin 5,000,000 EURO për rinovimin dhe ristrukturimin e kredive aktuale. Megjithatë për financimin e sektorëve të veçantë të ekonomisë dhe palëve të tjera të cilat konsiderohen me rrezik të tilla si sektori i lojërave të fatit, institucionet financiare, personat politikë, fondacionet etj., autoriteti për miratimin e kredive i mbetet Bordit të Drejtorëve pavarësisht shumës së financimit.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)

Rishikimit dhe vlerësimit të rrezikut të kredisë. Menaxhimi i Bankës dhe Sektori i Vlerësimit të Rrezikut të Kredisë vlerëson të gjithë kufinj të ekspozimit të kredisë, përpara miratimit përfundimtar nga autoriteti kompetent. Rinovimet dhe rishikimet e huave janë subjekt i po të njëjtit proces.

Kufizimit të përqëndrimit të ekspozimit ndaj kundërpartive, qofshin përqëndrime gjeografike apo sektorë të ekonomisë (për kreditë dhe paradhëniet) dhe sipas emetuesit, klasifikimit të kredive, likuiditetit të tregut dhe shtetit (për investimet në letra me vlerë).

Zhvillimit të mirëmbajtjes së sistemit të vlerësimit të rrezikut të Bankës për të kategorizuar ekspozimin sipas shkallës së rrezikut të humbjes financiare me të cilën përballet Banka dhe për të fokusuar drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Klasifikimi i rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur mund të kërkohet zhvlerësim kundrejt ekspozimeve specifike të kredisë.

Kuadri aktual i klasifikimit të rrezikut konsiston në pesë kategori: a) standarde, b) në ndjekje, c) nën-standarde, d) e dyshimtë dhe e) humbur. Kreditë e klasifikuara në dy kategoritë e para konsiderohen si kredi pa probleme. Kreditë e tre kategorive të tjera konsiderohen si kredi me probleme. Përveç kriterit të ditëvonesave, Banka gjithashtu përdor kriteret cilësore të mëposhtme për përcaktimin e kategorizimit të rrezikut të kredive:

- Aftësia paguese
- Kushtet financiare
- Aftësitë menaxhuese
- Kolateralin dhe garantët
- Struktura e kredive

Kreditë me kushte të rinegociueshme janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe për të cilat Banka ka bërë lëshime që përndryshe nuk do të konsideronte. Kreditë me kushte të rinegociueshme janë konsideruar si të zhvlerësuar individualisht në vitin e parë që nga implementimi i ristrukturimit.

Rreziku i angazhimeve të lidhura me kredinë

Banka vë në dispozicion të klientëve garanci që mund të kerkojnë që Banka të bëjë pagesa në emër të tyre dhe të hyje në angazhime për të zgjeruar linjat e kredisë për të siguruar nevojat e tyre për likuiditet. Letrat e kreditit dhe garancitë (duke përfshirë edhe letrat e kreditit në gatishmëri) angazhojnë Bankën për të bërë pagesa në emër të klientëve në rast të një akti të veçantë, në përgjithësi lidhur me importin ose eksportin e mallrave. Këto angazhime e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të ngjashme për kreditë dhe zbuten nga të njëjtat procese dhe politika të kontrollit.

Përkufizimi i dështimit dhe përmirësimit

Banka konsideron një instrument financiar të dështuar (humbur), dhe për rrjedhojë e kategorizon si Faza 3 për të përlogaritur HKP, në të gjitha rastet kur kredimarrësi është në vonesë mbi 90 ditë për detyrimet kontraktuale të tij. Banka konsideron balancat e thesarit dhe të tregut ndërbankar të dështuara, dhe merr masa të menjëhershme, kur pagesa e pritshme nuk është ekzekutuar në ditën e caktuar sipas kontratës mes palëve. Si pjesë e vlerësimit cilesor nëse një klient është në dështim, Banka gjithashtu konsideron një varietet elementesh të cilët mund të tregojnë pamundësi pagese. Në rast të një ngjarje të tillë, Banka me kujdes konsideron nëse ngjarja mund të rezultojë në trajtimin e klientit si të dështuar, e për rrjedhojë ta kategorizojë nën Fazën 3 apo Fazën 2 si më të përshtatshmen për të përlogaritur HKP. Ngjarje të tilla përfshijnë:

- a) Vështirësi të mëdha financiare të huamarrësit ose emetuesit;
- b) Shkelja e një kovenanti, si mospagimi ose ngjarje me ditë vonesa;
- c) Huadhënësit e huamarrësit, për arsye ekonomike ose kontraktuale të lidhura me vështirësitë ekonomike të huamarrësit, i kanë bërë një lëshim huamarrësit që huadhënësi nuk do ta kishte konsideruar në rrethana të tjera;
- d) Është duke u bërë e mundshme që huamarrësi të falimentojë ose të bëjë një ri-organizim financiar;
- e) Zhdukja e një tregu aktiv, si rezultat i vështirësive financiare;
- f) Blerja ose origjinimi i një aktivi financiar me një ulje të madhe që reflekton humbjet e pësuar të kredisë.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Përkufizimi i dështimit dhe përmirësimit (vazhdim)

Është politika e Bankes që të konsiderojë një instrument financiar si “të përmirësuar” dhe për rrjedhojë ta heqë nga Faza 3, kur asnjë prej kriterëve të klasifikimit si dështim nuk janë prezente të paktën për gjashtë muaj rrjesht. Vendimi nëse një aktiv i përmirësuar do të klasifikohet nën Fazën 2 apo në Fazën 1, përcaktohet nga kriteret e vendosura në momentin e përmirësimit.

Kriteri i Bankës për qëllimet e HKP-së është më pak i rreptë sesa kërkesa për 24 muajsh e ristrukturimit, që shpjegohet në shënimin 4.n.

Rritja e qënësishme e rrezikut kreditor

Banka në mënyrë të vazhdueshme monitoron të gjithë aktivet e saj të cilat janë subjekt i HKP-së. Me qëllim që të përcaktojë nëse një instrument financiar është subjekt i HKP 12 mujore (Faza 1) apo AGJHKP (Faza 2), Banka vlerëson nëse ka pasur rritje të qënësishme të rrezikut kreditor.

Banka aplikon gjithashtu një metodë të dytë qualitative për të shkaktuar një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë për një aktiv, si lëvizja e një klient/objekti në listën e vëzhgimeve, ose llogaria të bëhet e pavlefshme. Në raste specifike, Banka mund të konsiderojë gjithashtu dhe ngjarje të shpjeguara në shënimin 9 që janë një rritje e rëndësishme në rrezikun e kredisë në krahasim me një mospagim. Për më tepër, nëse pagesat kontraktuale kanë më shumë se 30 ditë vonesë, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur në mënyrë të ndjeshme që nga njohja fillestare.

Kur vlerësohen HKP-të në baza kolektive për grupe aktivesh të ngjashme (si në shënimin 9), Banka aplikon të njëjtat principe për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë.

Ekspozimi në dështim

Ekspozimi në dështim (EAD) përfaqëson vlerën bruto të instrumenteve financiare të cilat janë subjekt i përlllogaritjes së zhvlerësimit, duke adresuar si aftësinë e klientit që të rrisë ekspozimin e tij ndërkohe që mund të dështojë, ashtu edhe ripagesat potenciale para afatit. EAD për kartat e kreditit dhe të tjera ekpozime janë në shënimin 9.

Për të llogaritur EAD-në për një kredi në Fazën 1, Banka vlerëson ngjarjet për mospagesat e mundshme brënda 12 muajve për llogaritjen e 12mHKP. Për aktivet financiare në Fazën 2, Fazën 3 dhe POCl, ekspozimi në dështim konsiderohet për ngjarje gjatë gjithë jetës së instrumentit.

Banka përcakton EAD-të duke modeluar gamën e rezultateve të mundshme të ekspozimit në pika të ndryshme të kohës, që i korrespondojnë skenarëve të shumëfishtë.

Humbja në dështim

Humbja në dështim përfaqëson humbjen e përlllogaritur për ngjarjet e dështimit në një periudhë kohe. Një dështim mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar gjatë periudhës së vlerësuar, nëse objekti nuk është çregjistruar më pare dhe është akoma në portofol.

Me qëllim vlerësimin kolektiv të zhvlerësimit (Faza 1 dhe Faza 2), huatë grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë që janë tregues i aftësisë së debitorëve për të paguar të gjitha shumat për shkak të kushteve të kontratës (për shembull, mbi bazën e një procesi vlerësimi të kredisë ose gradimi që merr në konsideratë llojin e pasurisë, llojin e klientit, llojin e kolateralit, statusin e borxhit me vonesë dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm). Karakteristikat e zgjedhura janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme për grupe të këtyre huave, duke qenë tregues i aftësisë së debitorëve për të paguar të gjitha shumat për shkak të kushteve kontraktuale të aktiveve që po vlerësohen.

Metodologjia konsiston në:

- Krijimin e një grupimi për ekpozimet me karakteristika kreditore të ngjashme (p.sh. produktet)
- Llogaritje e një PD-je 12 mujore për cdo faze
- Llogaritja dhe pëarfësimi i PD-ve për gjithë jetën për çdo segment me përfshirjen e rregullimit Makro.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Definicioni i dështimit dhe përmirësimit (vazhdim)

Humbja në dështim

Llogaritja e LGD ka përbërësit e mëposhtëm:

- Probabiliteti i rikuperimit (Koeficienti i Rikuperimit)
- Norma e Humbjes pa Rikuperim

Ngjarjet e rikuperimit janë ekspozime që dalin nga statusi i dështimit (shprehin mundësinë e daljes nga statusi në Fazën 3). Pra ekspozimet që janë në transit nga statusi NPE ose FNPE në PE ose FPE në qe muaj nga periudha e observimit identifikohen si të rikthyera në statusin e performuesve dhe një ngjarje rikuperimi ka ndodhur. Ekspozimet konsiderohen se kanë ndaluar së qeni jo-performuese kur të gjitha kushtet në vijim plotësohen:

- Debitori nuk ka shuma me ditë vonesa më të mëdha se 90 ditë
- Një vit ka kaluar që kur masat rristrukturoese u zgjatën
- Situata e debitorit është përmirësuar deri në ripagim të plotë, sipas origjinalit ose kur është e aplikueshme prej kushteve të modifikuara, do të behen;

Norma e Humbjes përfshin vlerësimin e koeficienteve të rikuperimit për cdo segment duke vëzhguar rikuperimet kumulative historike si përqindje e shumës së mbetur. Përsa i përket rikuperimeve, pagesat monetare historike nga ekspozimet e dështuara merren në konsideratë.

Analiza e përqëndrimit të rrezikut

Banka monitoron përqëndrimin e rrezikut të kredisë për sektor. Një analizë e rrezikut të kredisë në datën e raportimi paraqitet më poshtë:

	Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Përqëndrimi sipas sektorëve		
Shërbimet	12,045	666,647
Shitja me shumicë	3,780,667	1,675,106
Ndërtimi	1,118,671	370,900
Prodhimi	2,562,289	891,522
Pasuritë e patundshme	876,368	903,783
Të tjera	3,084,111	1,750,893
Biznese	11,434,152	6,258,851
Kredi hipotekore	12,458,285	2,774,512
Kredi konsumatore	828,716	251,799
Individë	13,287,002	3,026,311
Vlera kontabël	24,721,153	9,285,162
	Hua dhe paradhënie bankave	
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Përqëndrimi sipas sektorëve		
Banka	6,266,933	5,078,902
Vlera kontabël	6,266,933	5,078,902
	Letra me Vlerë	
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Përqëndrimi sipas sektorëve		
Letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare	29,342,340	18,683,595
Vlera kontabël	29,342,340	18,683,595

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e përqëndrimit të rrezikut (vazhdim)

Cilësia e kredisë së ekspozimit maksimal të kredisë së letrave me vlerë të borxhit bazuar në klasifikimin Moody, kur është e aplikueshme, vijon si më poshtë:

Qeveria Shqiptare Klasifikimi B1	Investime Financiare (letra me vlerë të borxhit)	
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
	29,342,340	18,683,595
	29,342,340	18,683,595

Përqëndrimi i rrezikut të kredisë

Portofoli i rrezikut të kredisë së Bankës karakterizohet nga përqëndrimet e mëposhtme të rrezikut të kredisë.

	31 dhjetor 2018	Ekspozimi në %	31 dhjetor 2017	Ekspozimi në %
Letrat me vlerë të Republikës së Shqipërisë	29,342,340	41%	18,683,595	51%
Gjendjet me Bankën e Shqipërisë	16,148,958	23%	6,022,488	16%
Rreziku total me Qeverinë Shqiptare	45,491,298	64%	24,706,083	68%
Ekspozimi më i madh me Bankat	163,655	0%	689,764	2%
Ekspozimi më i madh me klientët	586,095	1%	421,098	1%
Totali i ekspozimeve të mëdha me bankat dhe klientët	749,750	1%	1,110,862	3%
Totali i rrezikut për zërat e bilancit	46,241,048	65%	25,816,945	71%

Pala tjetër për ekspozimin më të madh me bankat më 31dhjetor 2018 është me një Bankë e huaj, CA CIB (2017: Bankë vendase, Intesa San Paolo Bank). Pala tjetër për ekspozimin më të madh me klientët në 31 Dhjetor 2018 është Kastrati sh.a (2017: Korporata Energjitike Shqiptare).

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë

	Ekspozimi Maksimal Bruto	
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mjete monetare dhe të ngjashme (me përjashtim të mjeteve monetare ne arkë)	10,627,938	5,781,933
Hua dhe paradhënie bankave	5,950,972	2,718,602
Letra me vlerë të vendosjes	19,217,970	10,803,880
Letra me vlerë të investimit	10,124,370	7,879,715
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	24,721,153	9,285,162
Qira financiare	55,835	78,499
Debitorë të tjerë	78,728	12,327
Totali i ekspozimit për zërat e bilancit	70,775,566	36,560,118
Angazhime të patërheqshme ndaj klientëve	787,678	323,475
Garanci në favor të klientëve	721,997	512,288
Totali i angazhimeve të lidhura me kredinë	1,509,675	835,763
Totali i rrezikut të kredisë	72,285,241	37,395,882

Nëse aktivet financiare regjistrohen me vlerën e drejtë, shumat e paraqitura përfaqësojnë ekspozimin aktual të rrezikut të kredisë, por jo ekspozimin maksimal që mund të lindë në të ardhmen si rezultat i ndryshimeve në vlera. Banka vë në dispozicion të klientëve të saj garanci të cilat mund të kërkojnë që Banka të bëjë pagesa në favor të tyre dhe të marr angazhime për të zgjeruar linjat e kredisë për t'ju siguruar likuiditetin e nevojshëm. Angazhime të tilla e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të ngjashme të kredisë, të cilat zbuten me të njëjtat politika dhe procese kontrolli. Çdo muaj Banka vlerëson angazhimet e lidhura me kredinë për zhvlerësim. Shumat subjekt i vlerësimeve individuale për zhvlerësim janë angazhime të pa-anullueshme dhënë klientëve të këqinj ose klientëve me kredi të riskstrukturuara.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Tabela e mëposhtme jep informacion për cilësinë e kreditit të aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuara. Me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe, për aktivet financiare, vlerat e paraqitura në tabelë paraqesin vlerën e mbetur bruto. Për angazhimet kreditore dhe kontratat e garancive financiare, vlerat në tabela paraqesin shumën e angazhimit apo të garantuar.

	Më 31 dhjetor 2018				Më 31 dhjetor 2017	
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali	
Arka dhe llogari me Banken Qëndrore						
Risk i ulët – i drejtë	18,251,733	-	-	-	18,251,733	7,018,755
Pakësuar me zhvlerësimin	-	-	-	-	-	-
Vlera e mbartur	18,251,733	-	-	-	18,251,733	7,018,755
Hua dhe paradhënie bankave						
Risk i ulët – i drejtë	429,952	-	-	-	429,952	2,478,048
Pakësuar me zhvlerësimin	-	-	-	-	-	-
Vlera e mbartur	429,952	-	-	-	429,952	2,478,048
Letra me vlerë						
Risk i ulët – i drejtë	29,386,089	-	-	-	29,386,089	18,683,595
Në ndjekje	-	-	-	-	-	-
Pakësuar me zhvlerësimin	(43,749)	-	-	-	(43,749)	-
Vlera e mbartur	29,342,340	-	-	-	29,342,340	18,683,595
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve						
Risk i ulët – i drejtë	18,096,410	980,074	199,054	-	19,275,538	9,137,888
Në ndjekje	681,472	795,352	101,622	-	1,578,446	597,645
Nestandarte	135,766	226,121	1,520,346	-	1,882,233	255,608
I dyshimtë	118,826	139,117	1,999,846	-	2,257,790	120,849
I humbur	7,281	44	5,796,776	-	5,804,101	741,452
Pakësuar me zhvlerësimin	(403,974)	(383,869)	(5,283,942)	-	(6,071,785)	(1,568,281)
Vlera e mbartur	18,635,781	1,756,840	4,333,703	-	24,726,324	9,285,162

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

	Më 31 dhjetor 2018				Më 31 dhjetor 2017
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Qira financiare					
Risk i ulët – i drejtë	56,399	-	-	-	56,399
Në ndjekje	-	-	-	-	-
Nenstandarte	-	-	-	-	-
I dyshimtë	-	-	-	-	-
I humbur	-	-	-	-	-
Pakësuar me zhvlerësimin	(564)	-	-	-	(564)
Vlera e mbartur	55,835	-	-	-	55,835
Garancite dhe angazhimet e tjera financiare					
Risk i ulët – i drejtë	721,997	-	-	-	721,997
Pakësuar me zhvlerësimin	(5,171)	-	-	-	(5,171)
Vlera e mbartur	716,826	-	-	-	716,826
	Jo në vonesë dhe jo të zhvlerësuara individualisht	Në vonesë, por jo të zhvlerësuara individualisht	Të zhvlerësuara individualisht	Totali	
31 dhjetor 2017					
Mjete monetare dhe të ngjashme (pa përfshirë paranë në arkë)	5,781,934	-	-	5,781,934	
Hua dhe paradhënie bankave	2,718,602	-	-	2,718,602	
Hua dhe paradhënie klientëve:	9,834,632	157,784	861,027	10,853,443	
Hua tregtare	6,833,723	19,476	663,050	7,516,249	
Hua hipotekore	2,743,482	111,458	187,937	3,042,877	
Hua konsumatore	257,427	26,850	10,040	294,317	
Qira Financiare	81,346	-	-	81,346	
	18,416,514	157,784	861,027	19,435,325	
Investime në letra me vlerë:					
Qeveria Shqiptare	18,683,595	-	-	18,683,595	
Totali	37,100,109	157,784	861,027	38,118,920	

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

Një analizë vjetërsie e kredive në vonesë por jo të zhvlerësuara më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2018					Totali
	Më pak se 30 ditë	31 në 60 ditë	61 në 90 ditë	91 në 180 ditë	më shumë se 180 ditë	
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve:						
Hua tregtare	8,168,871	1,402,079	688,880	904,504	2,417,371	13,581,705
Hua hipotekore	9,672,009	599,750	412,420	355,388	955,837	11,995,405
Hua konsumatore	1,778,904	56,412	40,961	34,428	209,098	2,119,803
Qira Financiare	56,399	-	-	-	-	56,399
Totali bruto	19,676,184	2,058,241	1,142,261	1,294,320	3,582,306	27,753,311
Total HKP	901,811	187,689	206,726	246,859	1,433,237	2,976,323
Neto	18,774,373	1,870,551	935,535	1,047,461	2,149,068	24,776,988

Një analizë vjetërsie e kredive të konsideruara jo në vonesë dhe jo të zhvlerësuara individualisht më 31 Dhjetor 2017 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

31 dhjetor 2017	Jo në vonesë dhe jo të zhvlerësuara individualisht				Në vonesë, por jo të zhvlerësuara individualisht		
	Më pak se 30 ditë	31 në 60 ditë	61 në 90 ditë	Totali	91 në 180 ditë	më shumë se 180 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve:							
Hua tregtare	6,493,366	268,831	71,526	6,833,723	1,876	17,600	19,476
Hua hipotekore	2,470,260	119,065	154,157	2,743,482	58,502	52,956	111,458
Hua konsumatore	250,633	5,083	1,711	257,427	2,211	24,639	26,850
Qira Financiare	81,346	-	-	81,346	-	-	-
Totali bruto	9,295,605	392,979	227,394	9,915,978	62,589	95,195	157,784
Total HKP	609,996	86,173	23,435	719,604	14,343	56,973	71,315
Neto	8,685,609	306,806	203,959	9,196,374	48,246	38,222	86,469

Huatë dhe letrat me vlerë të zhvlerësuara

Huatë e zhvlerësuara janë ato për të cilat Banka vlerëson se mund të mos jetë në gjëndje të mbledhë principalin dhe interesin e arkëtueshëm sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes(ve) së huasë. Banka i klasifikon huadhëniet dhe paradhëniet ndaj klientëve në kategori pa probleme dhe me probleme siç përshkruhet më lart dhe kryen teste të zhvlerësimit për të gjitha huatë që shfaqin evidence objektive për zhvlerësim, duke vlerësuar fluksin e skontuar monetar të ardhshëm dhe duke e krahasuar me vlerën kontabël të mbetur respektive të huasë. Huatë, të cilat nuk paraqesin evidencë për t'u zhvlerësuar individualisht, vlerësohen për zhvlerësim në grup. Zhvlerësimi në grup aplikohet gjithashtu edhe për klientë të testuar individualisht por që kanë rezultuar të mos kenë nevojë për zhvlerësim individual.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

Tabela më poshtë tregon huatë dhe paradhëniet neto ndaj klientëve të klasifikuara në dy grupe kryesore, të zhvlerësuara individualisht dhe në grup.

	Ekspozimi Neto i huave dhe paradhëniet ndaj klientëve	
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Individualisht të zhvlerësuara		
Balanca bruto	6,516,449	861,027
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(2,182,900)	(780,209)
Vlera kontabël	4,333,549	80,818
Të zhvlerësuara në grup		
Balanca bruto	21,180,464	9,992,416
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(792,859)	(788,072)
Vlera kontabël	20,387,605	9,204,344
Total i vlerës kontabël të Huave dhe paradhëniet për klientët	24,721,154	9,285,162

Lëvizjet e veganta për zhvlerësimet individuale dhe në grup paraqiten të detajuara në shënimin 16.

Tabela më poshtë tregon **qiratë financiare neto** të kategorizuara brënda dy grupeve kryesore: të zhvlerësuara individualisht dhe në grup.

	Ekspozimi neto për qira financiare	
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Individualisht të zhvlerësuara		
Balanca bruto	-	-
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	-	-
Vlera kontabël	-	-
Të zhvlerësuara në grup		
Balanca bruto	56,399	81,346
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(564)	(2,847)
Vlera kontabël	55,835	78,499
Total i vlerës kontabël të Huave dhe paradhëniet për klientët	55,835	78,499

Lëvizjet për zhvlerësimin e qirasë financiare janë detajuar në shënimin 17.

Më poshtë është një analizë e balancave bruto dhe neto (nga zbritja për humbjet nga zhvlerësimi) për huatë e zhvlerësuara individualisht sipas klasifikimit të rrezikut:

	Hua dhe paradhënie klientëve të zhvlerësuar individualisht			
	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto
31 dhjetor 2018				
Risk i ulët – i drejtë	120,401	96,405		
Në ndjekje	96,697	72,718		
Nenstandarte	2,079,368	1,444,932		
I dyshimtë	1,404,936	980,521	403,624	80,818
I humbur	5,769,278	1,647,480	457,403	-
Totali	9,470,680	4,242,056	861,027	80,818

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Politikat e fshirjes nga librat kontabël

Banka fshin nga librat e saj një gjëndje huaje/letra me vlerë (dhe zbritjet për zhvlerësime nga humbje të lidhura me të) kur Komiteti i Çështjeve Sensitive dhe Provigjonimit (SAC) përcakton se huaja/letra me vlerë është e pa arkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacioneve për ndryshime të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajë më detyrimet, dhe përfitimet nga kolaterale nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë ekspozimin. Për kreditë e standardizuara me vlerë më të vogël, vendimet për fshirjen, bazohen në statusin specifik të vonesave në pagesa të produktit si edhe në veprimet ligjore të ndjekura lidhur me procedurën e zbatimit.

Banka zotëron kolateral kundrejt kredive dhe paradhënies ndaj klientëve. Banka zbaton udhëzimet e saj të brendshme mbi pranueshmërinë e klasave specifike të kolateraleve ose të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë. Banka zotëron kolaterale kryesisht në formën e:

- Hipotekave të pasurive të paluajtshme rezidenciale ose të biznesit;
- Pengjeve mbi aktivet e biznesit në funksionim, të tilla si makineri dhe pajisje, inventare dhe llogari të arkëtueshme;
- Mjete monetare të lëna garanci dhe letra me vlerë (si Bono Thesari), etj.

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes dhe përgjithësisht përditësohen mbi baza vjetore.

Flukset e parashikuara të të ardhurave nga kolaterale, përfshirë garancitë që mbulojnë ekspozimet, janë zakonisht burimi kryesor i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare nga kreditë me probleme. Disa nga parametrat e vlerësimit të përdorura për llogaritje janë:

- *Vlera e realizueshme e kolateraleve*, e cila përllogaritet duke ulur vlerën e tregut të kolateraleve me një 'faktor skontimi'. Kjo merr në konsideratë karakteristikat e grupeve të ngjashme të kolateraleve dhe supozon një vlerë mesatare të rikuperueshme të një kolaterali të caktuar, bazuar në eksperiencën e Bankës.
- *Koha e flukseve të parashikuara/pritura të parasë*, e cila i referohet kohës së pritshme të rikuperimit (në vite) të një lloji të caktuar kolaterali.

Kolaterali përgjithësisht nuk mbahet për huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare, përveç kur instrumentet financiare mbahen si pjesë e marrëveshjeve të riblerjeve dhe aktivitetit të huamarrjes të letrave me vlerë..

Për qëllimin e llogaritjes së zhvlerësimit individual të kredive dhe paradhënies ndaj klientëve, kolaterale që janë marrë në konsideratë për llogaritjen e zhvlerësimit janë vetëm pasuritë e paluajtshme, mjetet monetare të vendosura si kolateral dhe garancitë bankare.

Nuk ka kolaterale mbi huatë dhe paradhëniet ndaj bankave përveç rasteve të marrëveshjeve të riblerjes të anasjelltja. Për pjesën me të madhe të portofolit të kredisë vlera e drejtë e kolateralit tejkalon shumë e kredive, megjithatë, Banka normalisht e skonton vlerën e drejtë të kolateralit me të paktën 40% në mënyrë që të mbajë parasysh vështirësitë praktike dhe administrative të ekzekutimit të një kolaterali. Në këtë mënyrë Banka mbrohet nga mospagesat e mundshme nga klienti.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Kredi dhe paradhënie të zhvlerësuar

Më poshtë jepet detajimi i vlerës së mbartur të kredive dhe paradhënieve të zhvlerësuar individualisht (duke përfshirë ekpozime jashtë bilancit) sipas kategorive, së bashku me vlëren e drejtë të kolateralit të marrë nga Banka për të siguruar këto kredi:

31 dhjetor 2018	Hua të zhvlerësuar	Kolaterali me marzhet reduktuese
Korporatë+SME	4,364,093	3,922,814
SBE	413,977	364,046
Të siguruar individualisht	1,575,491	2,720,436
Të pasiguruar individualisht	162,888	-
Qira financiare	-	-
Garanci	35,000	3,329
Totali bruto	6,516,449	7,010,625
Total HKP	(2,182,900)	
Neto	4,333,549	

31 dhjetor 2017	Hua të zhvlerësuar	Kolaterali me marzhet reduktuese
Korporatë+SME	531,747	38,649
SBE	283,410	221,720
Të siguruar individualisht	190,317	421,838
Të pasiguruar individualisht	93,081	-
Qira financiare	-	-
Garanci	-	-
Totali bruto	1,098,555	682,206
Total HKP	(832,362)	
Neto	266,193	

Kur Banka mban prona të marra në zotërim nën emrin e tyre, konvertimi i tyre në para është qëllimi parësor i Bankës, nëpërmjet marketing të pronave në shitje. Të ardhurat përdoren për të zvogëluar ose likuiduar vlerën kontabël të huave. Nëse nuk ka oferta të kënaqshme, Banka e ka si praktikë të mbajë aktive të vlefshme për shitje derisa të marrë një ofertë më të mirë. Në varësi të nevojave operacionale dhe përshtatshmërisë së aktivitetit për t'i pëmbushur ato kushte, menaxhimi mund të vendosë të përdor pronën; në këto raste bëhet një riklasifikim i pronës në aktive afatgjata materiale të Bankës. Balancat respective të aktiveve të marra në zotërim janë dhënë në shënimin 20.

Struktura e kolateraleve të huave në Faza të ndryshme janë si më poshtë:

31 dhjetor 2018	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Pronë me marzhet të reduktuar	31,615,984	4,017,388	6,950,230	-	42,583,602
Pengje	-	-	-	-	-
Mjete monetare	1,315,217	50,531	60,396	-	1,426,143
Totali	32,931,202	4,067,919	7,010,625	-	44,009,745

1 janar 2018	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Pronë me marzhet të reduktuar	12,130,239	1,481,915	682,206	-	14,294,361
Pengje	-	-	-	-	-
Mjete monetare	533,460	2,372	-	-	535,831
Totali	12,663,699	1,484,287	682,206	-	14,830,192

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Kredi dhe paradhënie të zhvlerësuara (vazhdim)

Hua dhe paradhënie të ri-negociuara

Aktivitetet e ristrukturimit përfshijnë marrëveshje pagesë të zgjatura, modifikime dhe shtyrje të pagesave. Në vijim të ristrukturimit, llogaria e një klienti me vonesa rivendoset në statusin normal dhe menaxhohet së bashku me llogari të tjera të ngjashme. Totali i portofolit të ristrukturimeve gjatë vitit 2018 është 99 milion Lekë (2017: 289 milion lekë).

Më poshtë janë detajuar për produkt, vlerat kontabël të huave dhe paradhenieve ndaj klientëve të ristrukturuar, të netuara nga fondet e zhvlerësimit, gjatë gjithë jetës së produktit:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Tregtare	257,219	72,842	2,079,836	-	2,409,896	518,257
Hipotekore	435,034	197,531	463,740	-	1,096,305	292,302
Konsumatore	5,500	5,355	17,659	-	28,514	-
Totali	697,753	275,727	2,561,235	-	3,534,715	810,559

Rreziku i shlyerjes

Aktivitetet e Bankës mund të shkaktojnë rrezik në momentin e shlyerjes së transaksioneve dhe tregtimeve. Rreziku i shlyerjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një shoqërie në përbushjen e detyrimeve të saj për të dhënë mjete monetare, letra me vlerë ose aktive të tjera ashtu siç është rënë dakort në kontratë. Risku i shlyerjes me institucione financiare dhe kundërpartinë tjetër qeveritare përfshihet brenda një sistemi limitesh për të gjitha transaksionet me këto kundërparti dhe është objekt i monitorimit të përditshëm, përcaktuar dhe rregulluar sipas rregullores së Bankës Qendrore të Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankës".

b) Rreziku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është përcaktuar si paaftësia e mundshme e një institucioni për të përbushur detyrimet që ka për shkak të pamjaftueshmërisë së likuiditetit ose pamundësisë për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (risku i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit në aktive financiare pa ndikuar negativisht dhe në mënyrë të rëndësishme çmimet, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Përqasja e Bankës për të administruar likuiditetin është të sigurojë, sa më gjatë të jetë e mundur, të ketë gjithnjë likuiditet të mjaftueshëm për të përbushur detyrimet e saj në kohë, si në kushte normale dhe në kushte të vështira, pa pësuar humbje të papranueshme apo dëmtuar reputacionin e saj.

Menaxhimi i procesit të likuiditetit të Bankës përfshin:

- Financim të përditshëm, të menaxhuar nga monitorimi i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për të siguruar përbushjen e kërkesave. Kjo përfshin rivendosjen e fondeve në kohën që maturohen ose merren hua nga klientët;
- Mbajtjen e një portofoli aktivësh likuide dhe të arkëtueshme;
- Monitorimin e raporteve të likuiditetit të bilancit ndaj kërkesave të brëndshme dhe rregullatore; dhe
- Menaxhimi i përqendrimit dhe profilizimit të borxheve të maturuara.

Përgjegjësia për administrimin e situatës së përditshme të likuiditetit mbetet nën monitorimin e Sektorit të Thesarit. Raportet e përditshme dhe shkëmbimi i informacioneve ndërmjet funksioneve të ndryshme të Bankës mbulojnë flukset monetare të vlerësuara për ditën, javën, dhe muajin pasues që konsiderohen si periudha kyçe të menaxhimit të likuiditetit. Pikënisja e projekteve është analiza e maturitetit kontraktual të detyrimeve financiare dhe data e pritshme e mbledhjes për aktivet financiare. Menaxhimi i likuiditetit për periudhat afatshkurtra dhe afatmesme është nën përgjegjësinë e ALCO-s. ALCO analizon në baza mujore situatën e likuiditetit të Bankës dhe propozon veprimet që konsiderohen si të nevojshme.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuiditetit

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Elementi kyç i përdorur nga Banka për administrimin e rrezikut të likuiditetit është raporti i aktiveve likuide mbi detyrimet afatshkurtra dhe hendeku kumulativ deri në 3 muaj. Për këtë qëllim aktivet likuide konsiderohen mjetet monetare dhe ekuivalentët me to si dhe portofoli i letrave me vlerë të vlefshme për shitje. Raportet e likuiditetit të përcaktuara nga Banka janë në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë të vendosura nga Rregullorja "Mbi administrimin e rrezikut të likuiditetit".

Banka përllëgarit mbi baza javore dhe mujore raportet e mëposhtme: aktivet likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, huatë ndaj depozitave dhe aktivet likuide ndaj depozitave. Aktivet likuide konsiderohen mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, bonot e thesarit të qeverisë Shqiptare dhe çdo depozitë afatshkurtër me bankat të cilat maturohen brenda 7 ditëve.

Detaje të raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra gjatë periudhës raportuese ka qenë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mesatarja për periudhën	62.37%	56.96%
Minimumi për periudhën	51.32%	44.99%
Maksimumi për periudhën	70.97%	68.79%

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela në vijim tregon gjëndjen e likuiditetit të Bankës monitoruar aktualisht nga drejtimi i Bankës më 31 Dhjetor 2018. Janë marrë në konsideratë flukset monetare të paskontuara hyrëse/dalëse të Bankës për aktivet dhe detyrimet financiare të bilancit dhe jashtë bilancit, sipas maturiteteve kontraktuale dhe duke mos reflektuar ndonjë ripagesa të hershme apo supozime për historikun e mbajtjes. Nëse maturimi kontraktual nuk është i aplikueshëm, Banka ka përdorur gjykimin në vlerësimin e periudhës kur këto aktive dhe detyrime financiare do të maturohen.

31 dhjetor 2018	1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	mbi 5 vjet	Totali
AKTIVE						
Mjete monetare, neto	12,730,713	-	-	-	-	12,730,713
Rezerva e detyrueshme	2,601,490	364,704	1,641,168	1,229,619	-	5,836,981
Paradhënie bankave	113,991	-	-	-	-	113,991
Investime në letra me vlerë	2,160,732	930,691	3,063,022	18,904,692	9,427,068	34,486,206
Hua dhe paradhënie klientëve (hua bruto pa probleme)	629,461	1,258,923	5,665,152	7,550,067	7,275,479	22,379,082
Qira Financiare	1,251	2,446	11,141	45,324	-	60,162
Aktive financiare të tjera	205,867	-	8,341	3,718	-	217,925
TOTALI	18,443,506	2,556,763	10,388,824	27,733,419	16,702,547	75,825,060
DETYRIME						
Llogari rrjedhëse me bankat	-	-	-	-	-	-
Llogari rrjedhëse/kursimi me klientët	6,500,068	782,057	3,478,632	4,308,681	2,433,313	17,502,751
Depozita nga bankat	1,343,237	-	-	-	-	1,343,237
Depozita me afat nga klientët	4,440,738	6,647,477	26,511,410	10,999,357	233,734	48,832,715
Borxhi i varur	3,171	-	9,409	50,354	496,238	559,171
Detyrime financiare të tjera	36,722	676,160	21,811	-	-	734,693
TOTALI	12,323,937	8,105,694	30,021,261	15,358,391	3,163,285	68,972,568
HENDEKU TOTAL I ZËRAVE TË BILANCIT	18,465,173	(4,076,572)	(22,711,064)	6,628,317	8,788,606	7,094,460
Zëra jashtë bilanci (flukse monetare hyrëse)						
Zëra jashtë bilanci (flukse monetare dalëse)	13,438	189,449	245,759	151,799	187,234	787,678
HENDEKU TOTAL I ZËRAVE JASHTË BILANCIT	(13,438)	(189,449)	(245,759)	(151,799)	(187,234)	(787,678)
HENDEKU TOTAL 31 dhjetor 2018	6,101,131	(5,738,380)	(19,878,196)	12,223,229	13,352,028	6,064,813
HENDEKU I AKUMULUAR 31 dhjetor 2018	6,106,131	367,751	(19,510,445)	(7,287,215)	6,064,813	-

Si pjesë e administrimit të rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, Banka mban aktive likuide që përfshijnë mjete monetare dhe të ngjashme me to dhe letra me vlerë të borxhit të emetuara nga qeveria, të cilat mund të shiten lehtësisht për të përmbushur nevojat për likuiditet. Flukset monetare të prishme të Bankes për disa detyrime financiare variojnë në mënyrë të konsiderueshme nga flukset monetare kontraktuale si për shëmbull llogaritë rrjedhëse të klientëve të cilat piten të jenë të qëndrueshme dhe nuk priten të tërhiqen.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2017	1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	mbi 5 vjet	Totali
AKTIVE						
Mjete monetare, neto	6,778,201	-	-	-	-	6,778,201
Rezerva e detyrueshme	1,169,515	166,668	750,005	514,666	-	2,600,854
Paradhënie bankave	-	-	117,748	-	-	117,748
Investime në letra me vlerë	346,354	318,598	1,529,217	10,830,230	10,487,542	23,511,941
Hua dhe paradhënie klientëve (hua bruto pa probleme)	1,785,189	595,928	2,153,686	4,011,994	2,140,133	10,686,930
Qira Financiare	1,367	2,675	20,187	62,792	-	87,021
Aktive financiare të tjera	3,103	-	488	3,942	-	7,533
TOTALI	10,083,729	1,083,869	4,571,331	15,423,624	12,627,675	43,790,228
DETYRIME						
Llogari rrjedhëse me bankat	149,950	-	-	-	-	149,950
Llogari rrjedhëse/kursimi me klientët	3,509,621	466,439	2,098,977	2,007,155	1,385,077	9,467,269
Depozita nga bankat	906,880	-	-	-	-	906,880
Depozita me afat nga klientët	2,431,894	4,095,309	10,130,820	8,400,225	830,035	25,888,283
Borxhi i varur	2,559	-	11,192	55,041	949,132	1,017,924
Detyrime financiare të tjera	124,200	27,564	-	-	-	151,764
TOTALI	7,125,104	4,589,312	12,240,989	10,462,421	3,164,244	37,582,070
HENDEKU TOTAL I ZËRAVE TË BILANCIT	2,958,625	(3,505,443)	(7,669,658)	4,961,203	9,463,431	6,208,158
Zëra jashtë bilanci (flukse monetare hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Zëra jashtë bilanci (flukse monetare dalëse)	16,092	30,692	79,699	143,281	53,711	323,475
HENDEKU TOTAL I ZËRAVE JASHTË BILANCIT	(16,092)	(30,692)	(79,699)	(143,281)	(53,711)	(323,475)
HENDEKU TOTAL 31 dhjetor 2017	2,942,533	(3,536,135)	(7,749,357)	4,817,922	9,409,720	5,884,683
HENDEKU I AKUMULUAR 31 dhjetor 2017	2,942,533	(593,602)	(8,342,959)	(3,525,037)	5,884,683	-

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuditetit (vazhdim)

